



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë “Master i Shkencave
në Gjuhësi ”**

ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

.1 Prof.As. Dr Monika Hasani Hoshafi

2. Prof.As. Dr Albana Ndoja Deda


Maj 2023

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit në “Master i shkencave në gjuhësi” ofruar nga Institucioni i
Arsimit të Lartë: Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i gjuhësisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i shkencave në gjuhësi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM 353, datë 12.05.2010
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr 476, datë 09.10.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	PAE10 /PAK1
18	Numri i studentëve:	Vite akademike 2018-2021 22 {student}
19	Komente / të tjera:	-



2



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Më 16 dhe 17 janar 2023, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi vizitën në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan për vlerësimin e programit të studimit të Ciklit të dytë “Master i shkencave në gjuhësi”. Vlerësimi i këtij programi studimi bëhet për herë të parë nga ASCAL-i. Programi është organizuar në bazë të marrëveshjes së Kartës së Bolonjës dhe legjislacionit në fuqi. Ky program u hap me anë të VKM nr.353, datë 12.05.2010 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Kohëzgjatja e programit të studimit është 2 vite akademike, me 120 kredite, përkatësisht 60 kredite/vit dhe 1500 orë në vit.

Programi është i organizuar në lëndë e module të vlerësuara me kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi përfundon me marrjen e diplomës “Master i shkencave në gjuhësi”. Programi i studimit “Master i shkencave në gjuhësi” me strukturën e përmbajtjen e tij është në përputhje me fushën akademike të fakultetit, si institucion arsimor në fushën e shkencave humane. Për të kryer vlerësimin e programit të studimit GVJ u mbështet në RVB-në, bashkëshoqëruar me dokumentacionin përkatës, si dhe në takimet me të gjithë aktorët përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e këtij program studimi.


Fillimisht mund të themi se është bërë një punë e përgjegjshme për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë, për grumbullimin e të dhënave në shërbim të vlerësimit për akreditimin e programit. Ky aplikim është përvoja e parë për këtë departament, që mbulon programin e studimit. RVB-ja është ndërtuar në frymë kolegjiale, me objektivitet dhe qartësi dhe me përpjekje që të pasqyrohen me vërtetësi, gjendja aktuale e cilësisë së programit të studimit, stafit akademik dhe atij administrativ si dhe të infrastrukturës mbështetëse. RVB-ja është ndërtuar duke përdorur burime të nevojshme, duke e mbështetur çdo pohim në shkresën përkatëse që disponon Departamenti i Gjuhësisë, si dhe duke përdorur drejt terminologjinë e fushës së vlerësimit të cilësisë.

Programi i studimit është hartuar dhe zbatohet në përputhje me kërkesat e Ligjit të AL 80/2015, të akteve nënligjore dhe të urdhrave e rekomandimeve të Senatit Akademik dhe Rektoratit të Universitetit të Elbasanit.


Disiplinat gjuhësore dhe letrare që përbëjnë këtë program studimi janë planifikuar të ndara me silabuse dhe ngarkesa në ETCS. GVJ vëren se duhet një ngarkesë më e reduktuar për disa pedagogë, të cilët mbajnë disiplina jo të një natyre dhe të afërta.

Departamenti i GjSh-së , në Universitetin e Elbasani ka në përbërje staf akademik të kualifikuar për të përballuar më së miri kërkesat shkencore që shtron ky program studimi. GVJ-ja vërejt se stafit akademik duhet të jetë më i shtuar, në përmbushje të realizimit të programeve që departamenti ofron. Stafi akademik bën përpjekje për t’u kualifikuar dhe rritur në mënyrë të vazhdueshme nga pikëpamja akademike. GVJ-ja vërejt se stafi përfshihet pak ose në projekte e trajnime ndërkombëtare.

Ky program përballlet me sfidat e zhvillimit, përhapjes dhe konsolidimit të vlerave të qëndrueshme të traditës në fushë të gjuhësisë dhe albanologjisë.



Sfidë tjetër e programit është tërheqja e më shumë studentëve në këtë program studimi., për vitin 2020-2021 ka të regjistruar 8 studentë, ndërkohë në harkun kohor 2018-2021 kanë përfunduar studimet gjithsej 22 studentë. Ky është një problem i cili ndërthur shumë arsye dhe aktorë dhe nuk e vuan vetëm ky departament, por të gjitha departamentet që ofrojnë programe studimi në fushat humane në universitetet shqiptare publike e jopublike në vend. Si rrjedhojë prej UE-së, prej Fakultetit të Shkencave Humane , ku bën pjesë ky departament, duhen hartuar politika më të detajuara dhe gjithëpërfshirëse për të rritur numrin e studentëve. Strukturat përkatëse të UE-së duhet të jenë më në kontakt me të diplomuarit (Alumni) dhe të krijojnë databazën e Alumnit edhe në nivel departamenti.

A handwritten signature in blue ink is written over a blue rectangular stamp. The signature is stylized and appears to be 'Duroleg'. The stamp is partially obscured by the signature.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)

Raporti është përgatitur nga një grup ekspertësh të vlerësimit, njohur si Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ), ngritur nga ASCAL me Urdhër Nr. 92, datë 04.08.2022 në përputhje me dispozitat ligjore të MASR dhe ASCAL. Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar.

Grupi, në vlerësimin e tij, është bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brendshëm (RVB) dorëzuar nga Universiteti i Tiranës, dokumentacionin shoqërues të raportit dhe në vizitën organizuar pranë këtij institucioni më 04-05.10.2022. Po ashtu, grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet ligjore e nënligjore përkatëse, dhe udhëzimet e ASCAL-it.

Gjatë vizitës në Universitetin e Elbasanit, GVJ ka zhvilluar takime me të gjithë aktorët e institucionit të përfshirë në këtë proces: me strukturat drejtuese të fakultetit dhe departamentit që ofron programin e ciklit të dytë “Master i shkencave në gjuhësi”.

Ecuria e procesit është kordinuar nga Specialisti i ASCAL-it i cili ka asistuar GVJ-në dhe ka koordinuar procesin e mbledhjes së dokumenteve shtesë të kërkuara nga GVJ gjatë vizitës në institucion.


Grupi studioi me shumë kujdes Raportin e vlerësimit të brendshëm të Departamentit të gjuhësisë në Fakultetin e Shkencave Humane (tetor 2022) (RVB për programin “Master i shkencave në gjuhësi” për t’u njohur paraprakisht me gjendjen dhe problematikën e programit. Bazuar në këtë informacion u hartua një draft paraprak i raportit të GVJ-së, shoqëruar me një seri pyetjesh që lindën gjatë studimit të tij. Gjatë vizitës dy ditore (16 dhe 17 Janar 2023) pranë dy njësive që mbulojnë programin, pyetjet në fjalë iu adresuan personave përgjegjës. Përgjigjet e marra u bënë pjesë e dokumentit final të këtij raporti. Gjatë vizitës në IAL, GVJ mori kontakte dhe bisedoi me personat e poshtëshënuar;

- Dekani i Fakultetit të Shkencave Humane
- Përgjegjësin e departamentit të GjS
- Përgjegjësin e departamentit të GjLG
- Grupin e Vlerësimit të Brendshëm të programit
- Stafin akademik të Departamentit të Gjuhësisë
- Stafin akademik të Departamentit të Letërsisë dhe Gazetarisë
- Zyrën e Karrierës dhe Alumni
- Përfaqësues të Drejtorisë Juridike
- Përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Karrierës
- Drejtorinë e Kurrikulave
- Takim me Drejtorinë e Kërkimit shkencor
- Studentë të programit të studimit nga tri vitet akademike

- Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll arkivës.
- Sekretarinë mësimore
- Përfaqësues të Bibliotekës

GVJ vizitoi mjediset e mësimiit dhe aktivitetit tjetër studentor në IAL (auditorë, laboratorë, biblioteka).

Ky raport pasqyron përmbledhtazi mendimet tona për programin. Ndonëse në tërësinë e vet raporti ynë konfirmon gjetjet kryesore të RVB-së, ndan edhe qëndrime të ndryshme prej tij lidhur me aspekte të caktuara të gjendjes dhe shkallës së plotësimit të standardeve të cilësisë së programit. Në përfundim të këtij procesi, grupi përgatiti dhe dorëzoi draft-raportin tek kordinatori teknik i ASCAL-it.




Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë “Master i shkencave në gjuhësi”
në “Universitetin “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Konstatojmë nga shqyrtimi i dokumentacionit se Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (UNIEL) ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtarë. Këto programe studimi synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Kjo parashikohet dhe në nenin 2 të Statutit të UNIEL. Edhe departamenti i gjuhësisë, pranë Fakultetit të Shkencave Humane, UE “A. Xhuvani” ofron programe studimi, që janë në përputhje me vizionin e arsimit të lartë të shprehur në Ligjin për Arsimin e Lartë Nr. 80 /2015 datë 22. 07. 2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>[Evidenca 1.1 Statuti i UNIEL, evidencën 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Elbasanit; 1.16. Strategjia e Zhvillimit të FSHH-së dhe 1.17 Strategjinë e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë] https://ëëë.uniel.edu.al/51-universiteti/rektori-i-ue/1234-strategjia-e-zhvillimit-institucional-2020-2024</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Në parim vërejmë se programi “Master i shkencave në gjuhësi” (MSHGJ) është një program studimi që ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit të Elbasanit “A. Xhuvani, të Fakultetit të Shkencave Humane dhe me misionin dhe qëllimin e departamentit të gjuhësisë, që lidhet me fushën e gjuhësisë dhe të albanologjisë.</p> <p>[Evidenca 1.1. Statuti i Universitetit “A.Xhuvani”; Evidenca 1.2 Rregullore e Studimeve UNIEL; 1.17 Strategjinë e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë dhe 3.15A Korniza konceptuale e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”] https://ëëë.uniel.edu.al/universiteti-ue/legjislacion/akte-te-brendshme/1395-statuti-i-universitetit-te-elbasanit-aleksander-xhuvani-shkurt-2022</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në</p>	<p>Nga shqyrtimi i dosjes për akreditim konstatojmë se programi “MSHGJ” hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të Strategjisë për Zhvillim të UE “A.Xhuvani”, të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Strategjisë së Zhvillimit të Departamentit të Gjuhësisë; të Statutit të Universitetit “A.Xhuvani” dhe Rregullores së UE “A.Xhuvani”, të</p>


<p>përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>FSSH-së dhe të departamentit të gjuhësisë, si dhe me fushat e drejtimeve akademike të departamentit, konkretisht në fushën e gjuhësisë dhe të albanologjisë.</p> <p>[Evidencë 1.1. Statuti i Universitetit “A.Xhuvani”; 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Elbasanit; 1.16. Strategjia e Zhvillimit të FSSH-së dhe 1.17. Strategjinë e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë]</p> <p>https://ëëë.uniel.edu.al/universiteti-ue/legjislacion/akte-te-brendshme/1395-statuti-i-universitetit-te-elbasanit-aleksander-xhuvani-shkurt-2022</p> <p>https://ëëë.uniel.edu.al/51-universiteti/rektori-i-ue/1234-strategjia-e-zhvillimit-institucional-2020-2024</p> <p>https://ëëë.uniel.edu.al/universiteti-ue/legjislacion/akte-te-brendshme/1310-rregullore-e-studimeve-te-fakultetit-te-shkencave-te-natyres-te-universitetit-te-elbasanit-aleksander-xhuvani</p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Konstatohet se MSHGJ dhe strategjia e zhvillimit të këtij programi studimi është hartuar dhe realizohet në përputhje me vizionin kombëtar për arsimin e lartë, përshkruar në Ligjin Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; me Strategjinë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin (2017-2022), në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim; Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021 – 2030; Strategjinë e Zhvillimit Institucional (2020-2024) të Universitetit të Elbasanit “A.Xhuvani” dhe Strategjinë e Zhvillimit të Departamentit të Gjuhësisë (2020-2024).</p> <p>[Evidencë 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Elbasanit; 1.16 Strategjia e Zhvillimit e Fakultetit të Shkencave Humane; 1.17 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit]</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konfirmon se program i studimit, fushat e tij të përgjithshme dhe specifike janë plotësisht në përputhje me misionin e arsimit të lartë si e mirë publike dhe në përputhje me misionin dhe qëllimin e e UNIEL-it duke synuar plotësisht ruajtjen e vlerave dhe interesave kombëtare.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi I.2




Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Nga dokumentacioni konstatohet se UE ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike. “MSHGJ” është ndër programet e para të ciklit të dytë të hapura në këtë fakultet, por edhe në universitet. Departamenti i gjuhësisë përbëhet nga një staf akademik me përvojë dhe tituj akademikë. Gjithashtu, pjesë e këtij programi janë edhe profesorë të njësive të tjera të fakultetit, si qendra e studimeve albanologjike dhe ballkanologjike “Aleks Buda” dhe departamenti i letërsisë dhe gazetarisë. Departamenti i gjuhësisë ka aktualisht 5 (pesë) personel akademik të kategorisë “Profesor” prej të cilëve 1 (një) me titullin akademik “Profesor doktor” dhe 4 (katër) me titullin akademik “Profesor i asociuar”; 3 (tre) personel akademik të kategorisë “Lektor” me gradë shkencore “Doktor i shkencave”.</p> <p>[shih Evidenca 1.5 Urdhri i hapjes UNIEL; evidenca 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional; Shih edhe Tabela 1 dhe Tabela 2 tek Aneksi i Tabelave Përmbledhëse]</p> <p>https://ëëë.uniel.edu.al/fakultetet/fakulteti-i-shkencave-humane/njesite-perberese#</p> <p>https://uniel.ems.al/school/program/9346697f-b568-4cfd-97b4-acbb00d31a7f.aspx</p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet se departamenti i gjuhësisë është njësi bazë e FSHH-së, e cila ofron programe studimi në fushë të gjuhësisë, albanologjisë, fushave ndërdisiplinore (psikolinguistikë, sociolinguistikë, etnolinguistikë etj.), dhe “MSHGJ” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të FSHH-së, dhe të departamenteve përkatëse.</p> <p>Nga vizita në terren GVJ konstatoi se janë ende duke u punuar në nivel kombëtar aktet nënligjore sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p> <p>[Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.9 Pasqyrimi i Kodifikimit të Lëndëve të Programit të Studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; evidencën 1.26 Shkresa e QSHA për Kodin e programit të studimit]</p> <p>http://qsha.gov.al/infos/njesim_diplome/ligj_23-2018_10052018.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të</p>	<p>Konstatohet se program MSHGJ është konceptuar dhe organizuar përreth njohurive themelore të gjuhësisë së përgjithshme (fonetikë e fonologji, morfologji, leksikologji, sintaksë, semantikë, pragmatikë, stilistikë e ligjërim), të sociolinguistikës, të mënyrave të mësimin të gjuhëve dhe të trajtimit automatik të tyre. Ky program është programi kryesor i ciklit të dytë të departamentit, që është konceptuar për të çuar më tej studentët në ciklin e tretë të studimeve doktorale, po pranë departamentit të gjuhësisë.</p>



paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Ashtu si e tregon edhe emërtimi, ka një përputhje të plotë mes titullit të njësisë bazë dhe programit të studimit. [Evidencë 3.15 A dhe B Korniza konceptuale e programit të studimit (në shqip dhe anglisht); Shih tabela 1, 2 dhe 19 tek Aneksi i Tabelave Përmbledhëse]								
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Programi nuk ofron drejtim specifik jashtë profilit të institucionit .								
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Vërejmë se program MSHGJ vijon njohuritë e “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi” dhe e përgatit studentin për “Doktoratë në albanologji”, duke i dhënë kështu mundësi për të përparuar në karrierë akademike dhe për të kryer studime të thelluara të ciklit të tretë në programe doktorale brenda dhe jashtë vendit në fushën e gjuhësisë dhe të komunikimit. Nga takimi në terrern GVJ konfirmon se UNIEL ofron edhe trajnime profesionale të vazhdueshme për studentët dhe të diplomuarit, falë marrëveshjeve bashkëpunuese me institucione të ndryshme. [Evidenca 1.12 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; evidenca 3.15 A dhe B Korniza konceptuale e programit të studimit; shih edhe Tabela 3 - Të dhëna tabelore për numrin e programeve në ciklin I, II dhe III të studimeve, që ofrohen në njësinë përgjegjëse (struktura e programeve të studimit në FSHH), Aneksi i Tabelave]								
Konkluzione	<i>Konfirmohet se Programi i studimit është plotësisht në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						



Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse	Nga dokumentacioni i përgatitur nga UE konstatojmë se për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit MSHGJ, UNIEL-i siguron marrëdhënie të mira bashkëpunimi brenda institucionit përmes ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit. Veprimtaria akademike, ndihmës akademike dhe administrativo-financiare e institucionit, pasqyrohet në analizën vjetore institucionale.



<p>dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Departamenti i gjuhësisë, për ofrimin e “MSHGJ” bashkëpunon ngushtësisht me departamentet e tjera të FSHH-së, bashkëpunime të rregulluara dhe të përcaktuara edhe në rregulloren përkatëse të departamentit, në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>[Evidencë 1.10 Struktura organizative e UNIEL; evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; evidenca 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.29 Raport për veprimtarinë e programit të studimit “Master i shkencave në Gjuhësi” për vitin akademik 2020-2021]</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Konstojmë se për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të studentëve të programit të studimit MSHGJ janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi në nivel institucional nga Universiteti “A. Xhuvani” Elbasan me institucione të ndryshme universitare dhe kërkimore shkencore, që ofrojnë programe të ngjashme studimi, si edhe institucione që kanë si objektiv arkivimin, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe historike. Përmendim këtu marrëveshjen me Akademinë e Studimeve Albanologjike, Arkivin Qendror Shtetëror, Arkivin Digjital të Elbasanit etj. Veprimtaritë e kryera në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit janë të pasqyruara në analizën vjetore institucionale.</p> <p>[Evidencë 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; evidencën 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021; evidencën 1.30 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve; shih Tabela 5 tek Aneksi i Tabelave Përmbledhëse]</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Nga dokumentacioni i konsultuar pohojmë se UNIEL ka nënshkruar marrëveshje të posaçme për realizimin e praktikave profesionale për programet e ndryshme të studimit. Në vitin e dytë të studimeve, semestri i dytë, realizohet praktika në formën e kërkimit gjuhësor në terren, i cili synon të përmirësojë, të orientojë dhe të testojë dijet gjuhësore përgjatë 2 viteve të studimit në terrenin e kërkimit të faktit gjuhësor.</p> <p>[Evidencë 1.13 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave; evidencën 1.33 Paketa e praktikës për programin e studimit, me rregulloren dhe dokumentet shkresore për ekspeditën, 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit, silabusi i “Kërkimit gjuhësor në terren”]</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit vërejmë se departamenti i gjuhësisë me përfundimin e vitit akademik harton raportin e analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve përkatëse të studimit, që ofrojnë, dhe sigurisht të përfshirë në të dhe për “MSHGJ”.</p>

	[Evidencë 1.29 Raport për veprimtarinë e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi” për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 1.30 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve]			
Konkluzione	<i>Për realizimin e procesit akademik departamentet që mbulojnë programin kanë realizuar marrëveshje me inistitucione të rëndësishme Shkencore, Arsimore dhe Instiucione shtetërore. Nuk ka evidentime për marrëveshje me institucione jo publike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit pohojmë se programi i studimeve MSHGJ, përmban elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore përkatësisht në Ligjin “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, (neni 33, pika3), në udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në Statutin e Universitetit të Elbasanit, në rregulloret e brendshme të UE-së, të FSHH-së dhe të Departamentit të Gjuhësisë, në vendimet e Senatit të UE-së, si dhe në praktikën e deritanishme të studimeve universitare.</p> <p>Programi i studimeve MSHGJ është program studimesh universitare i organizuar në lëndë dhe i vlerësuar me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe në përputhje me shpërndarjen e veprimtarive formuese sipas VKM 41, datë 24.1.2018.</p> <p>[Tabela 9 - Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-E); Evidencë 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit; Evidencë 3.16 Plani mësimor i programit të studimit MSHGJ; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit MSHGJ</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuar në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Sipas dokumentacionit bashkangjitur, programi i studimit MSHGJ është: të përgatisë specialistë të nivelit të lartë dhe të qëndrueshëm në shkencat e gjuhës, si mësues i gjuhës shqipe për të huaj, punonjës në të gjitha profesionet që lidhen me komunikimin, në të gjitha profesionet e lidhura me përmirësimin e probleme në mësimin e gjuhës.</p> <p>[Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi” (3.15A shqip dhe 3.15B anglisht)</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Konstatohet se plani mësimor përfshin lëndët në auditor, kërkimin gjuhësor në terren dhe mikrotezën. Praktika parashikon të mundësojë përdorimin e kompetencave të fituara në kurset teorike në një kontekst praktik profesional kërkimor.</p> <p>Praktika zhvillohet në vitin e dytë të studimeve, semestri i dytë. Për të fituar diplomën e studimeve në “Master i shkencave në gjuhësi” .</p>

	<p>GvJ konstaton se kohëzgjatja e saj në 5 javë mësimore në terren është e mjaftueshme për konsolidimin e njohurive të marra në teori.</p> <p>[Shih Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.33 Paketa e praktikës për programin e studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.35. Rregullore e Kërkimit Gjuhësor në Terren; Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit); Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi” (3.15A shqip dhe 3.15B anglisht)]</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Profili i këtij programi është “Master i shkencave në gjuhësi”, pra përjashton fushën e mësuesisë.</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Programi përjashton fushën e mësuesisë.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Konstatohet se programi i studimit MSHGJ është hartuar dhe ofrohet në përputhje me Ligjin “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 (neni 84), në lidhje me format e organizimit të studimeve, pranimin e studentëve dhe financimin e tyre në UE me status të veçantë, të cilat realizohen në përputhje me këtë ligj dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin, qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p> <p>[Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit MSHGJ; Evidenca 1.20 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit MSHGJ; Evidenca 1.21 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit MSHGJ; Evidenca 4.16 Të dhëna që lidhen me</p>



	koston e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi MSHGJ]		
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit vërejmë se programi MSHGJ është i ngjashëm me programe të tjera të studimit që ofrohen në Universitetin e Tiranës (“Master i shkencave në gjuhësi të sotme”), Universitetin e Shkodrës (“Master i shkencave në studime të thelluara në gjuhësi), si edhe me universitete të tjera të trevave shqiptare në Kosovë, Maqedoni e Veriut. Kjo ngjashmëri ka lidhje me fushën e njëjtë të studimit (linguistika) dhe arritjet në fushën e albanologjisë.</p> <p>[Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MSHGJ; evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi” (3.15A shqip dhe 3.15B anglisht); evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”]</p>		
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	<p>Konstatohet se ky program i përket nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), ciklit të parë të studimeve universitare me numrin unik të identifikimit 000537 në regjistrin e diplomave të regjistruara në Ministrinë e Arsimit në Republikën e Shqipërisë dhe sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Kodifikimi i lëndëve të programit të studimit bëhet duket përdorur akronimet e programit të studimit (MGj), pastaj një vizë, dhe të lëndëve përkatëse (GJZ, p. sh. në rastin e Gjuhësisë së Zbatuar), pastaj vizë, dhe pastaj vitin kur zhvillohet lënda (p.sh. MGJ-GJZ-21).</p> <p>[Evidenca 1.9 Pasqyrimi i Kodifikimit të Lëndëve të Programit të Studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.26 Shkresa e QSHA për Kodin e programit të studimit MSHGJ; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”]</p>		
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk ka të dhëna për këtë kriter.		
Konkluzione	<i>Konstatohet se programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore. Në nivel kombëtar ka programe të ngjashme me këto lloj program studimi dhe përputhja në përmbajtjen e kurrikulave është mbi masën 70 për qind.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X



Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Konstatohet se njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit MSHGJ, është FSHH. Kjo njësi kryesore ka në përbërje të saj katër departamente si dhe një qendër kërkimore. Kjo përbërje e FSHH-së është në përputhje të plotë me detyrimet ligjore në fuqi. Programi i studimit “MSHGJ” që ofrohet në departamentin e gjuhësisë është organizuar sipas standardeve të Procesit të Bolonjës dhe legjislacionit në fuqi dhe përbën aktualisht të vetmin program studimi të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave” në programet e studimit që ofron ky departament. [Evidenca 1.5 Urdhri i hapjes UNIEL; Evidenca 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional; Evidenca 1.10 Struktura organizative e UNIEL dhe e FSHH-së; Evidenca 1.24 Urdhër “Për hapjen e Fakultetit të Shkencave Humane”; Evidenca 1.25 Urdhri për hapjen e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Tabela 1 - Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë; Tabela 2 - Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programin e studimit “Master i shkencave në gjuhësi”]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Konstatohet se ky kriter nuk aplikohet. Kështu, programi i studimit MGJSH përmban edhe anën praktike të zbatimit të njohurive gjuhësore, që lidhet me Kërkimin Gjuhësor në terren, të realizuar në semestrin e dytë të vitit të dytë të studimit. Në këtë program studimi nuk ka laboratorë dhe kështu nuk kërkohet angazhim i personelit ndihmës akademik. Në ekspeditën që zhvillohet në kuadrin e Kërkimit Gjuhësor në terren pedagogët i shoqërojnë vetë studentët, duke i udhëzuar për mbledhjen e materialit, kontaktin me informatorin gjuhësor etj. [Evidenca 1.33 Paketa e praktikës për programin e studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.35. Rregullore e Kërkimit Gjuhësor në Terren; evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”]</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Konstatohet se ka një kordinator programi studimi. Kordinatori i programit të studimit caktohet në detyrë nga drejtuesi i departamentit të gjuhësisë. Koordinator i programit përzgjidhet nga personeli akademik i departamentit, që ofron të paktën një kurs universitar në programin përkatës dhe ka të paktën gradën shkencore “doktor”. Njeh legjislacionin e arsimit të lartë, zotëron aftësi bashkërendimi dhe menaxhimi, ka aftësi të mira për të zgjidhur problemet dhe për të marrë vendime, aftësi për të ndërtuar dhe mbajtur partneritete me bashkëpunëtorët, aftësi të mira komunikimi dhe aftësi të përparuara digjitale. Detyrat e koordinatorit të programit të studimit MSHGJ janë përcaktuar në Rregulloren e këtij programi studimit, neni 4.2.2.</p>

	[Evidenca 1.22 Vendim për caktimin e kordinatorit të programit të studimit MSHGJ; Evidenca 1.23 Përshkrimi i detyrave të kordinatorit të programit të studimit MSHGJ]			
Konkluzione	<i>Njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbushin plotësisht kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi II.3


Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit pohojmë se programi i studimit “Master i shkencave në gjuhësi”, ofrohet nga departamenti i gjuhësisë në Fakultetin e Shkencave Humane të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”. Autoritetet drejtuese dhe organizuese të programit janë departamenti i gjuhësisë dhe kordinatori i programit të studimit, të cilët janë përgjegjës për këtë program studimi. Ata disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, detyra këto të përcaktuara në rregulloren e departamentit të gjuhësisë dhe rregulloren e programit të studimit, si edhe në strategjitë përkatëse të tyre.</p> <p>[Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.8 Rregullorja e programit të studimit MSHGJ; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MSHGJ]</p>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	<p>Pohojmë se plani mësimor është i detajuar sipas Veprimtarive Formuese (A-E) (sipas VKM Nr. 41, datë 24.1.2018), “Për Elementët e Programeve të Studimit”. Ndarja e lëndëve dhe moduleve në planin mësimor i përgjigjet këtyre kategorive të përcaktuara. Planin mësimor përfshin lëndë në auditor, kërkimin gjuhësor në terren dhe mikrotezën, si edhe ka karakter shumëdisiplinor. Ai mbështetet mbi disa blloqe kryesore: formimi bazë, formimi karakterizues në fushat përkatëse, formimi ndërdisiplinor.</p> <p>[Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit MSHGJ; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit MSHGJ, edhe Tabela 9 tek Aneksi i Tabelave Përmbledhëse]</p>


<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit MSHGJ përmban të gjitha informacionet e duhura për studentët që janë të interesuar ta ndjekin apo janë regjistruar në të. Këto informacione, si: kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, janë të hartuara dhe të mbështetura mbi një bazë rregullatore ligjore (rregulloret e UE-së, FSHH-së, departamentit të gjuhësisë) dhe iu ofrohen studentëve nga strukturat përgjegjëse të FSHH-së, siç janë: Dekanati i FSHH-së, departamenti i gjuhësisë, koordinatori i programit të studimit, personeli ndihmës akademik me karakter mësimor i FSHH-së.</p> <p>[shih Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të Universitetit të Elbasanit https://ëëë.uniel.edu.al/universiteti-ue/legjislacion/akte-te-brendshme/1308-rregullore-e-organizimit-dhe-funksionimit-te-universitetit-te-elbasanit-aleksander-xhuvani Evidenca 1.7 Rregullore e studimeve të FSHH-së https://ëëë.uniel.edu.al/images/studio_ne_ue/fakulteti_i_shkencave_humane/njoftime/Rregullore_e_FSHH.pdf Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit MSHGJ]</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatojmë se bazuar në Rregulloren e studimeve në UE, Rregulloren e studimeve të FSHH-së, si edhe në Rregulloren e programit të studimit MSHGJ, modeli i programit të lëndës që përdoret për hartimin e silabuseve përmban të gjitha elementet sipas përcaktimeve VKM nr. 41, datë 24.01.2018, pika 2.8. Silabuset e të gjitha lëndëve në këtë program studimi janë sipas këtyre përcaktimeve dhe përmbajnë: pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e detajuara të lëndës, format e kontrollit të dijeve, frekuentimin, kontrollin e vazhdueshëm, literaturën, vërejtje përfundimtare nga pedagogu i lëndës.</p> <p>[Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të Universitetit të Elbasanit https://ëëë.uniel.edu.al/universiteti-ue/legjislacion/akte-te-brendshme/1308-rregullore-e-organizimit-dhe-funksionimit-te-universitetit-te-elbasanit-aleksander-xhuvani Evidenca 1.7 Rregullore e studimeve të FSHH-së, nenin 24, pika 1; https://ëëë.uniel.edu.al/images/studio_ne_ue/fakulteti_i_shkencave_humane/njoftime/Rregullore_e_FSHH.pdf Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset, në shqip dhe anglisht) “Master i shkencave në gjuhësi”]</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit vërejmë se në fillim të çdo viti akademik titullari i çdo lënde paraqet për miratim në departament programin lëndor. Një kopje e tij depozitohet në formë elektronike dhe shkresore në departament, dhe kopja tjetër elektronike dhe shkresore detyrimisht</p>

dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	depozitohet pranë Drejtorisë së Kurrikulave dhe Standardeve në UE “Aleksandër Xhuvani”.		
	[shih Evidenca 3.14 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit MSHGJ; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit MSHGJ (shqip dhe anglisht); Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset, në shqip dhe anglisht) “Master i shkencave në gjuhësi”]		
Konkluzione	<i>Programi i studimit është informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht


Standardi II.4	
Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Në dosjen për akreditim pohohet se kurrikula e programit është hartuar mbi bazën e literaturës shkencore dhe përvojave mësimore të universiteteve evropiane (Gjermanisë, Francës, Italisë etj.) dhe gjithashtu në përfaqje me përvojat e mira të Universitetit të Prishtinës, të Tiranës, të Shkodrës, Palermos, Romës, pra, universiteteve me programe studimi në fushë të albanologjisë. Ky pohim u vërtetua edhe nga vizita e GVJ-së në terren. Emërtimi dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit MSHGJ janë konceptuar e hartuar me qëllimin që të mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për: 1. studime të mëtejshme -për të përparuar në karrierë akademike dhe për të kryer studime të thelluara të ciklit të tretë në programe doktorale brenda dhe jashtë vendit në fushën e gjuhësisë dhe të komunikimit; 2. për punësimin e studentëve, si: kërkues shkencorë në institucione kërkimore në fushë të gjuhësisë, komunikimit, studimeve humanistike etj., si kërkues dhe specialistë në arkiva, si punonjës të kualifikuar në biblioteka, mësues të kualifikuar, hartues tekstesh shkollorë, profesionistë të botimit në shtëpi botuese, specialistë të gjuhës në radio e televizione, mësues ndihmës në shkolla publike e private të specializuara, si specialistë komunikimi në shumë fusha, kërkues në studime empirike në sfera të ndryshme të organizuara nga institucione kombëtare, organizata ndërkombëtare dhe OJF etj. [Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MSHGJ;



	Evidenca 1.34 Politika e marketingut për programin e studimit MSHGJ; Evidenca 3.15. Korniza konceptuale e programit të studimit MSHGJ
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	<p>Vërejmë se programi është i organizuar në lëndë e module dhe i vlerësuar në kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe të Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p> <p>Zhvillimi i planit të kërkimit shkencor në lidhje me këtë program do të drejtohet nga: zhvillimi i kërkimit bazuar në fushat prioritare të miratuara nga departamenti në përputhje me strategjinë e kërkimit shkencor në UE, zhvillimin dinamik të karrierës akademike të stafit të departamentit, përfshirjen e departamentit dhe stafit akademik në mënyrë të drejtpërdrejtë në politikat kërkimore në funksion të rritjes akademike dhe profesionale, si dhe inkurajimin e studentëve për t'u përfshirë në projekte të ndryshme kërkimore të fushave me interes për ta. Departamenti nxit studentët të jenë pjesëmarrës në konferenca (studentore dhe jo vetëm), seminare dhe ëorkshope si dhe nëpërmjet detyrave të kursit, eseve, hartimit të temave të ndryshme kërkimore.</p> <p>[Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MSHGJ; Evidenca 1.34 Politika e marketingut për programin e studimit MSHGJ; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit MSHGJ]</p>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	<p>Nga konsultimi i dokumentacionit, vërejmë se programi i studimit MSHGJ është ndërtuar duke pasur parasysh kreditet vjetore që duhet të fitojë një student dhe orët vjetore të programuara, përkatësisht 60 kredite/vit dhe 1500 orë në vit. Programi ka një raport të drejtë ndërmjet disiplinave teorike e zbatimeve praktike të tyre dhe është në përputhje me profilin e programit të studimit në fushë të gjuhësisë.</p> <p>Kurrikula e programit është hartuar mbi bazën e literaturës shkencore dhe përvojave mësimore të universiteteve evropiane, Gjermanisë, Francës, Italisë etj., dhe gjithashtu në përfaqje me përvojat e mira të Universitetit të Prishtinës, të Tiranës, të Shkodrës, Palermos, Romës, pra, universiteteve me programe studimi në fushë të albanologjisë.</p> <p>[Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MSHGJ; Evidenca 1.34 Politika e marketingut për programin e studimit MSHGJ; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit MSHGJ; Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit MSHGJ; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit MSHGJ]</p>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve,	Në dojen për akreditim pohohet se në programin e studimit MSHGJ ndarja e veprimtarive formuese, e cila jepet e detajuar në planin mësimor dhe e përcaktuar në silabuset e lëndëve dhe moduleve dhe një raport teori – praktikë i ekuilibruar ndërmjet tyre, krijojnë mundësinë për një formim të plotë të studentëve, sipas drejtimit dhe profilizimit dhe objektivave



<p>mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>formuese të programit, gjë e cila u mundëson atyre transferimin e studimeve në institucione të tjera universitare me program të ngjashëm si, “Master në gjuhësi të sotme” në UT, “Master i shkencave në studime të thelluara në gjuhësi” në Universitetin e Shkodrës, Master në Gjuhësi në Universitetin e Prishtinës etj. Programi siguron një formim të plotë, në mënyrë të tillë që specialistët e përgatitur të jenë të aftë të përshtaten shpejt në grupe kërkimore, në institucione kërkimore-shkencore, si dhe në subjekte të tjera publike e jopublike që kanë nevojë për specialistë të gjuhës.</p> <p>[Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MSHGJ; Evidenca 1.34 Politika e marketingut për programin e studimit MSHGJ; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit MSHGJ; Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit MSHGJ; Evidenca 5.15 Pyetësi i Alumnit zhvilluar nga departamenti i gjuhësisë]</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit vërejmë se në fillim të çdo viti akademik, në departamentin e gjuhësisë rishikohen, diskutohen dhe miratohen silabuset e çdo lënde të këtij programi studimi. Përmirësimi i kurrikulës ekzistuese të programit të studimit MSHGJ, silabuseve të lëndëve të këtij programi studimi, synon të garantojë rritjen e cilësisë së tij, duke pasqyruar kërkesat dhe zhvillimet e reja shkencore dhe kulturore, që kushtëzohen nga dinamikat e brendshme të shoqërisë shqiptare, nga dinamikat dhe profilet e zhvillimit të Rajonit të Ballkanit, nga familja politike e Bashkimit Evropian në të cilin synon të integrohet shoqëria shqiptare, nga zhvillimet globale. Përditësimi i literaturës, reflektimi i ndryshimeve që sugjerohen nga kërkesat e studentëve dhe studiuesve të rinj dhe të produktit shkencor të stafit të departamentit pasqyrohet në këto silabuseve, temat përkatëse të tyre.</p> <p>Të gjitha kurset universitare në këtë program studimi janë të pajisura me tekstet përkatëse origjinale ose të përkthyer, ose me cikël leksionesh të përgatitura nga pedagogu i lëndës në formë dispense. Përpos teksteve bazë, studentëve iu referohet literaturë plotësuese në shqip dhe në gjuhë të tjera, si anglisht, italisht, frëngjisht.</p> <p>[Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MSHGJ; Evidenca 1.34 Politika e marketingut për programin e studimit MSHGJ; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit MSHGJ; Evidenca 3.1 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit MSHGJ; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit MSHGJ]</p>



<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit konstatohet se programi është konceptuar dhe organizuar përreth njohurive themelore të gjuhësisë së përgjithshme (fonetikë e fonologji, morfologji, leksikologji, sintaksë, semantikë, pragmatikë, stilistikë e ligjërim), të sociolinguistikës, të mënyrave të mësimit të gjuhëve dhe të trajtimit automatik të tyre.</p> <p>Përmbajtja e tij synon nxitjen e mendimit kritik dhe krijues, me qëllim zhvillimin e frymës së kërkimit shkencor për të gjetur, dalluar dhe studiuar dukuri, faktorë që nxisin komunikimin më të mirë gjuhësor dhe jogjuhësor të individit në shoqëri e më gjerë; njohjen, zbulimin dhe promovimin e vlerave kulturore dhe shkencore të rajonit dhe më gjerë. Studentëve në këtë program, krahas njohurive në disiplina të tjera të studimit dhe disiplinave të përafërta, u ofrohen edhe kompetenca të tjera të nevojshme për të përgatitur jo vetëm profesionistë të mirë, por edhe qytetarë të angazhuar në shoqëri.</p> <p>[Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit MSHGJ; Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit MSHGJ]</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Konstatohet se ky program studimi u krijon mundësinë studentëve për specializime të mëtejshme në disiplina më të ngushta, si didaktikë e gjuhës, industri e gjuhës, mjeshtri në multimedie dhe shtypshkrim, komunikim, politika gjuhësore, shkenca sociale, shkenca të edukimit etj). Studentët që përfundojnë këtë program studimi, mund të vijnë studimet e tyre në shkollën doktorale, në albanologji.</p> <p>Përmbajtja e programit të studimit MSHGJ mundëson punësimin në sektorin publik e privat apo edhe në sektorë të tjerë si kërkues shkencorë në institucione kërkimore në fushë të gjuhësisë, komunikimit, studimeve humanistike etj, si kërkues dhe specialistë në arkiva, si punonjës të kualifikuar në biblioteka, mësues të kualifikuar, hartues tekstesh shkollorë, profesionistë të botimit në shtëpi botuese, specialistë të gjuhës në radio e televizione, mësues ndihmës në shkolla publike e private të specializuara, si specialistë komunikimi në shumë fusha, kërkues në studime empirike në sfera të ndryshme të organizuara nga institucione kombëtare, organizata ndërkombëtare dhe OJF etj.</p> <p>[Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MSHGJ; Evidenca 1.34 Politika e marketingut për programin e studimit MSHGJ; Evidenca 5.15 Pyetësori i Alumnit zhvilluar nga departamenti i gjuhësisë]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Kurrikula e programit është hartuar mbi bazën e literaturës shkencore dhe përvojave mësimore të universiteteve evropiane (Gjermanisë, Francës, Italisë etj.) dhe gjithashtu në përfaqje me përvojat e mira të Universitetit të Prishtinës, të Tiranës, të Shkodrës, Palermos, Romës, pra, universiteteve me programe studimi në fushë të albanologjisë.</i></p>




	<i>Ky program studimi u krijon mundësinë studentëve për specializime të mëtejshme në disiplina më të ngushta, si didaktikë e gjuhës, industri e gjuhës, mjeshtri në multimedie dhe shtypshkrim, komunikim, politika gjuhësore. Studentët që përfundojnë këtë program studimi, mund të vijojnë studimet e tyre në shkollën doktorale, në albanologji.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>Nga materialet që gjenden në dosjen për akreditim, pohojmë se departamenti i gjuhësisë, në fund të çdo viti akademik organizon mbledhje në lidhje me diskutime mbi përmbajtjen e programit të studimit. Departamenti i gjuhësisë zhvillon pyetësorë me studentët që ndjekin këtë program studimi dhe me studentët që kanë përfunduar këtë program studimi (Alumni) në lidhje me çështje që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit MSHGJ, punësimin e tyre etj. Në nivel institucional, realizohet një pyetësor studentor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga Komisioni i Përhershëm për Standardet e Cilësisë.</p> <p>[Evidenca 3.14 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit “Master i shkencave në gjuhësi” (në 3 vite); Evidenca 1.34 Politika e marketingut për programin e studimit MSHGJ; Evidenca 1.12 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; Evidenca 1.29 Raport për veprimtarinë e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi” për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 1.30 Raporti i fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve; Evidenca 5.15 Pyetësori i Alumnit zhvilluar nga departamenti i gjuhësisë]</p>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimin të programit të studimit.	<p>Konstatojmë se studentët kanë të drejtë vendimmarrjeje, duke pasur mundësi të ndikojnë drejtpërsëdrejti në aspektet e punës së universitetit, si edhe në aspektin e përmirësimin të programit të studimit MSHGJ. Qëndrimi dhe mendimi i studentëve në lidhje me përmirësimin e cilësisë së këtij programi studimi merren edhe përmes instrumenteve të caktuara, si janë pyetësorët. Ato realizohen nga strukturat e UE-së apo edhe fakulteti dhe departamenti. Pyetësorët, si instrumente matëse të mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve, shërbejnë përmes të dhënave</p>


	<p>të tyre, për të nxjerrë probleme e sugjerime në lidhje me programin e studimit dhe përmirësimin e tij.</p> <p>[Evidenca 2.2 Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL; evidenca 2.3 Rregullore e Këshillit Studentor; Evidenca 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës https://ëëë.uniel.edu.al/universiteti-ue/legjislacion/akte-te-brendshme/1302-rregullore-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-komisionit-te-perhershem-ne-nivel-institucioni-per-marredheniet-me-studentet-dhe-keshillimin-e-karrieres</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Marrja e informacionit në lidhje me politikat arsimore të institucioneve dhe strukturave përkatëse të MAS-së në lidhje me vlerësimin e programit të studimit MSHGJ dhe peshën e pikëzimit të këtij masteri në dosjen personale të mësuesit, luajnë një rol të rëndësishëm në reflektimin për përmirësim të këtij programi studimi.</p> <p>Informacionet në lidhje me trajnimet e mësuesve që kanë ndjekur programin e studimit MSHGJ, nga institucione publike dhe jopublike, tematika e trajnimeve dhe moduleve të ofruara, përmbajtja e tyre, të cilat mund të merren nga burime të ndryshme dhe nga vetë mësuesit, përbëjnë të dhëna orientuese për përditësimin e informacionit në lidhje me përmbajtjen e lëndëve dhe moduleve të këtij programi studimi, si edhe propozime të reja.</p> <p>Pasi merren këto të dhëna, në mbledhjet e departamentit propozohen ndryshime në programet e kurseve universitare (silabuse), futjen e lëndëve të reja, fillimisht me zgjedhje, e më tej, sipas feed-back nga studentët, gjykohet nëse lënda mund të futet në grupin e lëndëve me zgjedhje.</p> <p>[Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MSHGJ; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit MSHGJ; Evidenca 3.14 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit të studimit MSHGJ]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Informacionet në lidhje me trajnimet e mësuesve që kanë ndjekur programin e studimit MSHGJ, nga institucione publike dhe jopublike, tematika e trajnimeve dhe moduleve të ofruara, përmbajtja e tyre, të cilat mund të merren nga burime të ndryshme dhe nga vetë mësuesit, përbëjnë të dhëna orientuese për përditësimin e informacionit në lidhje me përmbajtjen e lëndëve dhe moduleve të këtij programi studimi, si edhe propozime të reja. GVJ verën se ende ka hapësira {rrjete, organizma} që mund të sfrytëzohen për hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.6 Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit vërejmë se programi i studimit MSHGJ i ka të përcaktuara prioritetet dhe objektivat kryesore të studimit dhe kërkimit shkencor, të pasqyruara në strategjinë e programit të studimit MSHGJ dhe duke u bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Strategjisë Kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin (2017-2022), miratuar me vendim Nr. 710, datë 1.12.2017; në përputhje me Statutin e Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” miratuar 2018; Strategjinë e Zhvillimit Institucional (2020-2024) të Universitetit të Elbasanit “A. Xhuvani” dhe Strategjinë e Zhvillimit të Departamentit të Gjuhësisë (2020-2024).</p> <p>[Evidenca 1.1 Statuti i Universitetit të Elbasanit; Evidenca 1.3 Strategjia e zhvillimit të Universitetit të Elbasanit https://ëëë.uniel.edu.al/images/Strategjia_2020-2024_per_publicim.pdf ; Evidenca 1.16 Strategjia e zhvillimit e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MSHGJ]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Konstatojmë se programi i studimit MSHGJ organizohet dhe drejtohet nga departamenti i gjuhësisë, i cili drejton dhe kontrollon, në mënyrë kolegjiale gjithë veprimtarinë akademike, kërkimore, botuese, administrative dhe financiare të programit. Autoritetet drejtuese dhe organizuese të programit janë departamenti i gjuhësisë dhe koordinatori i programit të studimit, të cilët bashkërendojnë dhe administrojnë veprimtarinë e mësimdhënies, veprimtarinë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit, MSHGJ.</p> <p>[Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të Universitetit të Elbasanit https://ëëë.uniel.edu.al/universiteti-ue/legjislacion/akte-te-brendshme/1308-rregullore-e-organizimit-dhe-funksionimit-te-universitetit-te-elbasanit-aleksander-xhuvani ; Evidenca 1.7 Rregullore e studimeve të FSHH-së https://ëëë.uniel.edu.al/images/studio_ne_ue/fakulteti_i_shkencave_hu_mane/njofitime/Rregullore_e_FSHH.pdf ; Evidenca 1.8 Rregullore e</p>




	programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë]
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	<p>Nga vëzhgimi në terren dhe në bazë të dokumentacionit mund të pohojmë se departamenti nxit studentët të jenë pjesëmarrës në konferenca (studentore dhe jo vetëm), seminare dhe ëorkshope si dhe nëpërmjet detyrave të kursit, eseve, hartimit të temave të ndryshme kërkimore. Produktet shkencore të studentëve, si detyra kursi, temëdiploma, mikroteza depozitohen në mënyrë elektronike dhe të printuar pranë departamentit dhe shërbejnë si të dhëna kërkimore dhe, nga ana tjetër, pedagogët udhëheqës shkencorë i kanë nxitur studentët t’i botojnë këto punime, i kanë përfshirë në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare në UNIEL dhe në botimet e posaçme të Buletinit UNIEL.</p> <p>[Evidenca 2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022; evidenca 2.6 Të dhënat mbi revistën periodike BULETINI UNIEL; Tabela 22 tek Aneksi i Tabelave Përmbledhëse; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MSHGJ]</p>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	<p>KONstatojmë se institucioni ka mbështetur departamentin e gjuhësisë në zhvillimin e konferencave shkencore, në infrastrukturë, bazë materiale (kancelari) etj., por nuk administron të ardhura për aktivitete të ndryshme. Buxheti i universitetit financon kërkimin gjuhësor në terren, konferencat, promovimet etj. UE “A. Xhuvani” mbështet financiarisht veprimtaritë studimore, kërkimore e shkencore të njësisë bazë dhe administron të ardhurat nga veprimtari të ndryshme. Këto veprimtari lidhen edhe me organizimin e ekspeditave studimore për studentët, organizimin e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare në UNIEL si dhe publikimi nga personeli akademik dhe studentët në revistën periodike “Buletini shkencor UNIEL”.</p> <p>[Evidenca 4.14 Miratimi i Buxhetit 2021 dhe Buxhetit 2022; evidenca 2.4 Realizimi i ekspeditave studentore për vitin akademik 2021-2022; evidenca 3.3 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022; evidenca 3.4 Të dhënat mbi revistën periodike BULETINI UNIEL].</p>
Konkluzione	<p><i>Departamenti nxit studentët të jenë pjesëmarrës në konferenca (studentore dhe jo vetëm), seminare dhe ëorkshope si dhe nëpërmjet detyrave të kursit, eseve, hartimit të temave të ndryshme kërkimore. Produktet shkencore të studentëve, si detyra kursi, temë diploma, mikroteza depozitohen në mënyrë elektronike dhe të printuar pranë departamentit dhe shërbejnë si të dhëna kërkimore. Punimet, i kanë përfshirë në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare në UNIEL dhe në botimet e posaçme të Buletinit UNIEL.</i></p> <p><i>Mungon përfshirja e studentëve në projekte të mirëfillta kërkimore-shkencore.</i></p>




Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>Në dokumentacionin në dosjen për akreditim pohohet se departamenti i gjuhësisë mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore përmes: 1. Rritjes së bashkëpunimit mes komunitetit të kërkuesve shkencorë dhe biznesit përmes identifikimit të subjekteve me interes të veçantë dhe hartimit të projekteve të përbashkëta, që do të mundësojnë zbatimin e projekteve të përbashkëta kërkimore. Intensifikimi i bashkëpunimit me departamente të tjera të FSHH-së, QSAB-së pranë FSHH-së dhe departamenteve të tjera të UE-së në funksion të projekteve kërkimore ndërdisiplinore. 2. Përfshirjen e stafit në botime, recensime, editime, peer-review në Buletinin Shkencor të UNIEL-it dhe nxitjen e përfshirjes së studentëve dhe produkteve të tyre shkencore. 3. Ndërgjegjësimin e opinionit publik dhe institucioneve vendimmarrëse mbi rëndësinë e kërkimit shkencor në fushë të gjuhësisë, etnologjisë, albanologjisë, përmes organizimit të veprimtarive informuese, ekspozitive mbi rëndësinë e veprimtarisë shkencore për bizneset, opinionin e gjerë publik dhe rritjes së bashkëpunimit mes komunitetit të kërkuesve shkencorë dhe biznesit.</p> <p>[Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MSHGJ]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>Dokumentacioni i shqyrtuar nga ne pohon se departamenti i gjuhësisë angazhohet për të lidhur marrëveshje të reja të bashkëpunimit me aktorë të rinj të veprimtarisë shkencore e kulturore; për të përfshirë sa më shumë organizata publike dhe jopublike në modele bashkëpunimi afatshkurtra, afatmesme ose afatgjatë me departamentin e gjuhësisë; për konsolidimin e marrëdhënieve me njësi të tjera shkencore gjuhësore të IAL-ve në hapësirën shqiptare; aktivizimin e modeleve të bashkëpunimit (përmes bashkëpunimit me rektoratin e UE-së) me universitete që ofrojnë programe në fushën e studimeve gjuhësore dhe krijimi i mundësive për të integruar bashkëpunimin në programet ndërkombëtare të mobilitetit dhe kërkimit si Erasmus+, Horizont 2020 etj; aplikimin në projekte kërkimore e projekte shkencore të përbashkëta si partnerë më institucione të tjera homologe ose me interesa në fushën e kërkimit në fushat e gjuhësisë dhe albanologjisë.</p>



	<p>GVJ vëren se studentët e MSHGJ nuk janë përfshihen në mobilitete për të përfituar nga financime të Universitetit dhe përtej (institucioneve evropiane).</p> <p>[Evidenca 1.12 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit; Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MSHGJ; Evidenca 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+]</p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>Sipas strategjisë së zhvillimit të UE-së që gjendet bashkangjitur dhe dokumenteve të tjera, kostatojmë se me mbështetjen e strukturave të UE-së, departamenti i gjuhësisë organizon dhe mbështet realizimin e konferencave kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare si mjedise të nxitjes së debatit shkencor në fushën e gjuhësisë në përgjithësi në funksion të kërkimit shkencor, hartimin, organizmin dhe realizimin e projekteve shkencore dhe të veprimtarive shkencore (konferenca, seminare, ditë akademike) për çdo vit.</p> <p>Sa u përket studentëve, departamenti i gjuhësisë në bashkëpunim dhe me mbështetjen e UE-së, i nxit ata të jenë pjesëmarrës në konferenca (studentore dhe jo vetëm), seminare dhe ëorkshope si dhe nëpërmjet detyrave të kursit, eseve, hartimit të temave të ndryshme kërkimore.</p> <p>[Shih Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MSHGJ; Evidenca 3.18 Të dhëna të plota për kërkimin shkencor të stafit akademik në kuadër të programit të studimit; evidenca 3.3 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022;]</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.</p>	<p>Po në bazë të strtegjisë së zhvillimit të UE-së pohojmë se një nga synimet e departamentit të gjuhësisë, të pasqyruara në strategjinë e departamentit dhe të programit të studimit MSHGJ, është të përmirësojë kurrikulën ekzistuese të programit të studimit për të garantuar rritjen e cilësisë së tij. Përmirësimi lidhet jo vetëm me ofrimin e kurseve të reja, por edhe me përditësimin e literaturës, silabuseve, reflektimin e ndryshimeve që vijnë nga kërkesat e studentëve dhe studiuesve të rinj dhe të produktit shkencor të stafit të departamentit. Në këtë mënyrë të garantohet një propozim studimi tërheqës për studentët dhe në përshtatje me nevojat e tregut dhe shoqërisë, përparësitë e zhvillimit kombëtar, rajonal dhe evropian dhe të formohen specialistë të lartë dhe të përgatiten shkencëtarë të rinj në fushën e gjuhësisë dhe të albanologjisë, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të shkencës e arsimit në vend.</p> <p>[Evidenca 1.17 Strategjia e zhvillimit të departamentit të gjuhësisë; evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit MSHGJ]</p>




Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Dokumentacioni në dosje shprehet se në lidhje me këtë kriter nuk ka kompetencë departamenti i gjuhësisë dhe programit i studimit MSHGJ marrjen e licencës dhe ndërmjetësimin për marrjen e saj.		
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Vërejmë se dokumentacioni pohon se nuk ofrohet program studimi për profesione të rregulluara.		
Konkluzione	<i>Puna për përmirësim dhe përshtajten me njohuri të reja , kërkesat për përditësimin e literaturës, silabuseve, reflektimin e ndryshimeve që vijnë nga kërkesat e studentëve dhe studiuesve të rinj dhe të produktit shkencor të stafit të departamentit garantojnë një studim tërheqës për studentët dhe në përshtatje me nevojat e tregut dhe shoqërisë, përparësitë e zhvillimit kombëtar, rajonal dhe evropian dhe të formohen specialistë të lartë dhe të përgatiten shkencëtarë të rinj në fushën e gjuhësisë dhe të albanologjisë, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të shkencës e arsimit në vend.GVJ vëren se duhet zgjeruar përpjekjet për ndërkombëtarizimin e programit të sapu në nivel rajonal.</i>		
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve



<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Organizimi i mësimdhënies kryhet sipas tematikave që përmban silabusi i lëndëve. Ky i fundit përgatitet nga personeli akademik dhe miratohet në nivel departamenti e dekani. Për të siguruar një mbarëvajtje sa më ndërvepruese të mësimdhënies përdoren mjetet e teknologjisë së informacionit si projektorë e kompjuterë. Orët e mësimi i përshtaten natyrës së lëndëve me qëllim angazhimin e të gjithë studentëve në funksion të një nxënieje efikase. Studentët marrin pjesë në leksione dhe seminare e përgatisin detyra kursi. Kjo qasje, jo vetëm nxit interesin te studenti, duke i krijuar liri veprimi dhe mendimi, por njëherazi mundëson rezultate të suksesshme në vlerësimin e lëndës. Një tjetër aspekt është organizimi i leksioneve të hapura me lektorë/profesorë vendas e të huaj të ftuar, për t'u dhënë studentëve njohuri dhe përvojë në masën e nevojshme për t'i aftësuar në kërkimin shkencor.</p> <p>[Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset, në shqip dhe anglisht) “Master i shkencave në gjuhësi”; Tabela 13 - Ngarkesa totale në auditor e studentëve për format e mësimdhënies në programin e studimit, për secilin program]</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Përmirësimet në mësimdhënie realizohen me synimin për t'iu përshtatur nevojave të studentëve. Pjesa më e madhe e lëndëve/moduleve të programit përmbajnë detyrimin për përgatitjen e detyrave të kursit, në grup ose në mënyrë individuale. Projektet/detyrat e kursit i aftësojnë studentët në përthithjen dhe zbatimin e informacionit teorik, por dhe në të punuarin në grup. Personeli akademik respekton diversitetin e nevojave të studentëve duke operuar me forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies me qëllim gjithëpërfshirjen. Studentët kanë mundësi të marrin pjesë në konsultime që organizohen nga personeli akademik (konsultimet kryhen sipas agjendës së planifikuar) për të përvetësuar konceptet themelore të lëndëve si dhe për t'u konsultuar lidhur me projektet/detyrat e kursit.</p> <p>[Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 3.13 Informacion për politikën e zhvillimit dhe të përmirësimit të kurrikulave; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset, në shqip dhe anglisht) “Master i shkencave në gjuhësi”; Tabela 13 - Ngarkesa totale në auditor e studentëve për format e mësimdhënies në programin e studimit, për secilin program]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënësve.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të shqyrtuar konstatohet se UE zhvillon dhe mbështet mekanizma që i mundësojnë personelit akademik përmirësimin e kompetencave didaktike. UE ofron mundësinë e mobilitetit të personelit akademik dhe ndihmësakademik pranë universiteteve partnere, për përmirësimin e kompetencave të tyre. Institucioni është i hapur, kështu, dhe mundëson përdorimin e</p>




	<p>metodave të shumëllojshme pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme.</p> <p>[Evidenca: 1.3 Strategjia e Zhvillimit të Universitetit të Elbasanit https://ëëë.uniel.edu.al/images/Strategjia_2020-2024_per_publicim.pdf ; evidenca 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus+ ; evidenca 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personelit]</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Dokumentacioni i shqyrtuar dhe që gjendet në dosje pohon se UE ka përcaktuar kritere të detajuara për rekrutimet e personelit akademik. Rekrutimi i personelit akademik me kohë të plotë/e të pjesshme bëhet me konkurse, bazuar në kritere të përgjithshme dhe kritere të veçanta. Kriteret e veçanta të rekrutimit përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit.</p> <p>Përmes dokumenteve ligjore të Universitetit, por edhe të fakultetit dhe të departamentit, stafi akademik kujdeset që të ketë marrëdhënie të respektit të ndërsjellë me studentët, të organizojë një mjedis të përshtatshëm dhe nxitës të mësimdhënies, si edhe përmes koordinorit të programit të studimit synohet që të ketë një komunikim sa më të mirë mes grupit të studentëve, pedagogëve, stafit administrativ dhe drejtuesve të njësive universitare.</p> <p>[Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.23 Përshkrimi i detyrave të koordinorit të programit të studimit; Evidenca 6. 5 Kodi i Etikës UNIEL]</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Sipas dokumentacionit që gjendet në dosje vërejmë se për matjen e cilësisë së mësimdhënies në UE përdoren instrumente të përcaktuara qartë, lidhur me vlerësimin e studentëve e të vetë departamentit, në bashkëpunim me njësitë e vlerësimit të cilësisë në nivel institucional. Për këtë analizohen: 1. Sondazhet e studentëve që ndjekin programin e studimeve, të të diplomuarve në këtë program në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve. 2. Sondazhet e vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; 3. Rezultatet e arritura nga studentët në provime; 4. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të mikrotezës.</p> <p>Departamenti i gjuhësisë dhe secili pedagog i angazhuar në MSHGJ në fund të zhvillimit të çdo lënde realizon një pyetësor anonim për cilësinë e zhvillimit të saj.</p> <p>[Evidenca 1.29 Raport për veprimtarinë e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi” për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 3.14 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit “Master i shkencave në gjuhësi” (në 3 vite), evidenca 4.19 Vlerësimi i</p>



	performancës së personelit akademik; Tabela 21 - Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve]		
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Konstatojmë se UE ka në përbërje të saj një strukturë ndihmësakadematike me funksion koordinim institucional, kërkim shkencor dhe projektet. Struktura ka organizuar veprimtari të ndryshme informuese mbi mundësitë që u ofrohen personelit akademik për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Në UE është ngritur dhe funksionon Qendra e të Mësuarit Gjatë Gjithë Jetës (LLL Centre) e krijuar si produkt i projektit për ngritjen e kapaciteteve TEAVET. [Evidenca 3.3 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022; Evidenca 1.32 Analiza vjetore e departamentit të gjuhësisë 2020-2021; Evidenca 3.5 Marrëveshja për krijimin e qendrës TEAVET]		
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metoda dhe praktika të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Veprimtaritë teorike, praktike, informuese dhe shkencore garantojnë rezultate të mira gjatë procesit mësimor.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Sipas dokumentacionit të shqyrtuar, pohojmë se kriteret dhe mënyra e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në Rregulloren e FSHH-së dhe në rregulloren e programit të studimit të MSHGJ. Në çdo fillim të vitit akademik studentët njihen me të gjitha dokumentet e për vlerësimin e njohurive, të përmbajtjes dhe të kohës së tyre të vlerësimit. Mënyra e kontrollit të njohurive për çdo modul/lëndë përcaktohet edhe në silabusin përkatës, i cili i bëhet me dije studentëve që në fillim të vitit akademik ose semestrit përkatës. Rregullorja e UE-së dhe e FSHH-së mund të gjenden nga studentët dhe publiku në uebin e Universitetit, ndërsa ajo e programit të studimit dhe departamentit u shpërndahet studentëve prej koordinatorit të programit të studimit. [Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 1.7



	Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë]		
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Konstatohet se në fillim të lëndëve/semestrave studentët informohen me silabuset e secilës lëndë, në të cilat parashikohet veç tematikave që trajtohen në secilën javë, edhe mënyra e vlerësimit të lëndës, pesha specifike të secilës rubrikë dhe format e ndryshme të testimit. [Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset, në shqip dhe anglisht) “Master i shkencave në gjuhësi”; Tabela 15 - Format e kontrollit të njohurive]		
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Bazuar në rregulloren e FSHH-së si dhe në rregulloren e programit të studimit konstatohet se janë përcaktuar format kryesore të kontrollit për vlerësimin e nivelit të njohurive që ka përvetësuar studenti gjatë zhvillimit të lëndës/modulit, si: frekuentimi, pjesëmarrja dhe aktivizimi në seminare, dorëzimi i detyrave dhe projekteve, provimi i ndërmjetëm/kolokium dhe provim përfundimtar. Mënyrat e kontrollit të dijeve përcaktohen në programin e modulit dhe planin mësimor të studimeve dhe i bëhen të njohura studentëve në fillim të vitit akademik nëpërmjet prezantimit të silabuseve të lëndëve. [Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset, në shqip dhe anglisht) “Master i shkencave në gjuhësi”; Tabela 15 - Format e kontrollit të njohurive]		
Konkluzione	<i>Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të studentëve janë të përcaktuara në Rregulloren e FSHH-së dhe në rregulloren e programit të studimit të MSHGJ. Ato janë të zbatueshme dhe të prekshme edhe nga studentët.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të	Në dokumentacion parashikohet se vlerësimi i vazhduar i njohurive dhe dijeve parashikohet në silabuset e çdo programi lëndor dhe zë një përqindje të konsiderueshme në varësi të tipologjisë së lëndës dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar nga titullari i lëndës/komisioni i vlerësimit. Për lëndët të cilat konsiderohen firma, vlerësimi i vazhduar

<p>parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>zë 100% të vlerësimit përfundimtar, ndërsa në lëndët e tjera vlerësimi i vazhduar zë së paku 40% të vlerësimit final të studentit.</p> <p>[Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset, në shqip dhe anglisht) “Master i shkencave në gjuhësi”; Tabela 15 - Format e kontrollit të njohurive]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në dokumentacion pohohet se UNIEL zbaton prej disa vitesh edhe sistemin e automatizuar të korrigjimit të provimeve, falë projektit CLEANSCORE të financuar nga AADF.</p> <p>Por, nga ana tjetër, pohohet se në programin e studimit MSHGJ, për shkak të numrit të pakët të studentëve të përfshirë, kryesisht për shkak të nivelit cilësor të këtij programi studimi dhe kërkesave të pakta për studime albanologjike në rang kombëtar, testimi i njohurive teorike dhe praktike kryhet përmes detyrave të kursit dhe prezantimeve (provime) me gojë.</p> <p>(Shih Evidenca 3.4 Marrëveshja për implementimin e CLEANSCORE)</p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Konstatohet se vlerësimi përfundimtar i studentëve parashikohet të bëhet në bazë të parashikimeve të silabusit të lëndës dhe në bazë të rregullores së studimeve. Përcaktimet e rregullores së studimeve në FSHH dhe pranë departamentit të gjuhësisë garantojnë një vlerësim të drejtë të studentëve, transparent dhe bazuar mbi meritën.</p> <p>[Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset, në shqip dhe anglisht) “Master i shkencave në gjuhësi”; Tabela 15 - Format e kontrollit të njohurive]</p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit vërejmë se vlerësimi i studentëve realizohet në bazë të përcaktimeve të rregullores së studimeve, bëhet transparent dhe sipas rastit shoqërohet me këshilla për të përmirësuar njohuritë në të ardhmen.</p> <p>Në programin e studimit MSHGJ testimi i njohurive teorike dhe praktike kryhet përmes detyrave të kursit dhe prezantimeve (provime) me gojë. Në këto prezantime pedagogët kanë mundësi, përmes kontaktit të drejtpërdrejtë dhe konfidencial, të këshillojnë studentin, që të përmirësohet në aftësimin e tij teorik e praktik.</p> <p>[Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Tabela 15 - Format e kontrollit të njohurive; Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit)]</p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në dokumentacioni që gjendet në dosjen për akreditim pohohet se komisionet e vlerësimit të provimeve, të mikrotezave dhe udhëheqësit e</p>

	<p>tyre kujdesen në shmangien e kopjimit dhe plagjiaturës në provime dhe në hartimin e mikrotezës.</p> <p>[Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit në FSHH)]</p>		
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Sipas dokumentacionit bashkangjitur vërejmë se rezultatet e studentëve presupozohen të bazohen në meritë dhe jepen në kohë, sipas rregulloreve në fuqi dhe parashikimeve në silabuset e lëndëve. Gjithashtu, vlerësimi në mënyrë konfidenciale i komunikohet studentit dhe shënohet në sistemin EMS (Education Management System), sistemi elektronik i komunikimit në UE, në të cilin çdo student ka akses dhe një profil të vetin.</p> <p>[Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 4.11 Rregullorja EMS]</p>		
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Sipas rregulloreve bashkangjitur pohohet se studentëve u garantohej e drejta për t’u njohur me vlerësimin, për të bërë rishikimin e vlerësimit dhe e drejta për rivlerësim, sipas rregullores së studimeve në UE, FSHH, të departamentit të gjuhësisë dhe të programit të studimit MSHGJ. Nota e provimit i shfaqet studentit brenda 48 orësh në sistemin EMS, dhe studentit mund të kërkojë rishikim të vlerësimit të tij.</p> <p>[Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 4.11 Rregullorja EMS]</p>		
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Dokumentacioni i dosjes, i bashkangjur, pohon se në rastet kur studentët janë të pakënaqur më rezultatet e vlerësimit, ai paraqet një ankesë pranë drejtuesit të njësies bazë. Ky i fundit ngre një komision rivlerësimi (i cili nuk është i njëjtë me komisionin e parë), i cili rishqyrton dokumentacionin e provimit në mënyrë transparente. Vendimi i komisionit të rivlerësimit është i formës së prerë dhe depozitohet në departament dhe në sekretarinë mësimore.</p> <p>[Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UE/DGj siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit. GVJ rekomandon mbajtjen e një regjistri të posaçëm në nivel fakulteti për rastet e ankimit të studentëve.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
		X	

Standardi III.4**Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Sipas rregulloreve bashkangjitur dhe startegjisë së zhvillimit të UE-së konstatojmë se programi i studimit MSHGJ ofron dije të integruara me qëllim që t'i aftësojë studentët të kryejnë studime të thelluara dhe në përputhje me dijet dhe metodologjitë bashkëkohore në fushën e gjuhësisë. Programi i studimit është i ndërtuar sipas një sistemi progresiv dijesh akademike dhe njohurish profesionale, duke synuar kështu nga njëra anë thellimin e njohurive bazë dhe, nga ana tjetër, informacione rreth nivelit të zbatueshmërisë së tyre në praktikë. Programi, përmes lëndëve që ofron, përgatit specialistë të nivelit të lartë dhe të qëndrueshëm në shkencat e gjuhës, i cili mund të zbatojë njohuritë e tij si mësues i kualifikuar i gjuhës (në shkollat e mesme), si kërkues në terren në fushë të gjuhësisë, specialist për përmirësimin e nivelit të aftësive gjuhësore të nxënësve.</p> <p>[Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi” (3.15A shqip dhe 3.15B anglisht)]</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Sipas dokumenteve bashkangjitur vërejmë se programi MSHGJ përgatit specialistë të nivelit të lartë dhe të qëndrueshëm në shkencat e gjuhës, i cili mund të zbatojë njohuritë e tij si mësues i kualifikuar i gjuhës (në shkollat e mesme), si kërkues në terren në fushë të gjuhësisë, specialist për përmirësimin e nivelit të aftësive gjuhësore të nxënësve, si mësues i gjuhës shqipe për të huaj, punonjës në të gjitha profesionet që lidhen me komunikimin, në të gjitha profesionet e lidhura me përmirësimin e probleme në mësimin e gjuhës.</p> <p>Po sipas këtij dokumentacioni, vërejmë se njëkohësisht ky program u krijon ndjekësve të tij mundësinë e një specializimi më të mtejshëm në disiplina më të ngushta, si didaktikë e gjuhës, industri e gjuhës, mjeshtri në multimedie dhe shtypshkrim, komunikim, politika gjuhësore, shkenca sociale, shkenca të edukimit etj).</p> <p>[Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi” (3.15A shqip dhe 3.15B anglisht); Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”]</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në</p>	<p>Sipas dokumentacionit të konsultuar, vërejmë se në përfundim të lëndës/modulit personeli akademik bën një vlerësimin të nivelit të</p>




<p>programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>aftësive dhe kompetencave të fituara të studentëve me qëllim nxjerrjen e problematikave, nisur nga rezultatet e studentëve në funksion të përmirësimit të silabusit të lëndës. Departamenti organizon në fund të çdo viti akademik rishikimin periodik të programit të studimit dhe rregullores së studimeve. Rishikimi periodik i programit të studimit bëhet në bazë të ecurisë së studentëve në çdo lëndë/modul për nivelin e kompetencave dhe aftësive që ata kanë fituar dhe konkluzionet e nxjerra nga analizat e kryera reflektohen në programin e studimit. Gjatë rishikimit vëmendje i kushtohet: shpërndarjes së krediteve për modulën apo grup - modulet përkatëse; elementëve përbërës të moduleve dhe ndarjes së krediteve ndërmjet tyre (leksione, seminare, detyra, projekte, laboratorë etj.); bazës së nevojshme didaktike për realizimin e programit të studimit, evidentimit të mangësive dhe marrjes së masave për vitin pasardhës; literaturës së përdorur, mungesave të vërejtura dhe masave për përmirësimin e situatës; mekanizmave të kontrollit të dijeve/provimeve dhe analizës së rezultateve të kontrollit.</p> <p>[Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”]</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Nga dokumentacioni bashkangjitur dhe vizita në UE konstatohet se në programin e studimit MSHGJ praktika realizohet në një lëndë të veçantë, e cila zgjat 5 javë: Kërkimi gjuhësor në terren, që synon të përmirësojë, orientojë dhe të testojë dijet gjuhësore përgjatë 2 viteve të studimit në terrenin e kërkimit të faktit gjuhësor.</p> <p>Përgjatë kësaj periudhe studentët, fitojnë aftësi të punës në terren, krijojnë vetëdije mbi rëndësinë e kërkimit shkencor në gjuhësi, aftësohen të orientojnë kërkimin mbi dukuri reale gjuhësore dhe etnogjuhësore. Gjatë kësaj periudhe ata janë të shoqëruar dhe drejtuar nga pedagogë të departamentit dhe që janë pjesë e stafit mësimdhënës të këtij programi</p> <p>Kërkimi gjuhësor në terren parashikon të mundësojë përdorimin e kompetencave të fituara në kurset teorike në një kontekst praktik profesional kërkimor.</p> <p>[Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 3.15 Korniza konceptuale e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi” (3.15A shqip dhe 3.15B anglisht); Evidenca 1.35. Rregullore e Kërkimit Gjuhësor në Terren]</p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit bashkangjitur, vërejmë se personeli akademik i departamentit është angazhuar në mbajtjen e orëve të hapura mësimore me qëllim integrimin e risive të gjuhësisë botërore në kërkimin shkencor në gjuhën shqipe. Përgjatë viteve akademike departamenti është angazhuar të ftojë pedagogë (brenda dhe jashtë Shqipërisë) të cilët kanë përparuar në fusha e disiplina të veçanta gjuhësore, kanë</p>

	<p>pasur sukses në përvetësimin e teorive moderne gjuhësore dhe studimeve në fushë të gjuhësisë bashkëkohore. Këto leksione dokumentohen në faqen e internetit të departamentit (facebook e instagram), si edhe në ëeb sit-in e UNIEL-it. Këto leksione të hapura pasqyrohen edhe në raportet e përvitshme analitike të veprimtarive të departamentit të gjuhësisë.</p> <p>[Evidenca 1.29 Raport për veprimtarinë e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi” për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 1.31 Analiza vjetore e Fakultetit të Shkencave Humane 2020-2021; Evidenca 1.32 Analiza vjetore e departamentit të gjuhësisë 2020-2021]</p>		
<p>Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Në dokumentacionin që gjendet në dosjen për akreditim konstatohet se studentët e MSHGJ janë angazhuar në pjesëmarrje në konferenca studentore dhe në projekte kërkimore të përbashkëta me pedagogët udhëheqës.</p> <p>UE nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët, duke mundësuar financiarisht realizimin e konferencave studentore ndërkombëtare, publikimin në revistën periodike Buletini Shkencor.</p> <p>[Evidenca 3.3 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022; Evidenca 3.4 Të dhënat mbi revistën periodike BULETINI UNIEL]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UE nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët, duke mundësuar financiarisht realizimin e konferencave studentore ndërkombëtare, publikimin në revistën periodike Buletini Shkencor.</i></p> <p><i>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>


Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.</p>	<p>Konstatohet se procedura e detyrimeve përmbyllëse për studentët e MSHGJ është e parashikuar në rregulloren e FSHH-së, në rregulloren e programit të studimit dhe në paketën e punimit të diplomës. Studentët njihen me këto rregullore në fillim të studimeve.</p> <p>[Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore</p>



	e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.35. Rregullore e Kërkimit Gjuhësor në Terren; Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit)]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Sipas rregulloreve dhe dokumenteve bashkangjitur, vërejmë se koordinatori i programit të studimit është personi përgjegjës, i cili bashkërendon punën për hartimin dhe përmirësimin e rregullores së programit të studimit, për përgatitjen e strategjisë së zhvillimit të programit, për përgatitjen e dokumentacionit pedagogjik: planit mësimor, paketës së praktikës dhe të paketës së punimit të diplomës dhe bashkërendon veprimtaritë për punimin e mikrotezës së studentëve. [Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit)]
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në varësi të dokumentacionit bashkangjitur, pohojmë se vlerësimi final i studentëve në programin e studimit MSHGJ bëhet nëpërmjet mbrojtjes së mikrotezës. Pasi e ka përgatitur mikrotezën, ai paraqitet para një komisioni të posaçëm të ngritur me propozim të drejtuesit të departamentit dhe të miratuar nga dekani i FSHH-së. Gjithashtu, drejtuesi i departamentit ka caktuar edhe dy oponentë, që e kanë lexuar mikrotezën dhe japin vlerësimin e tyre me gojë dhe me shkrim për punën e studentit. [Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit)]
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.	Sipas dokumentacionit bashkangjitur, konstatojmë se në fillim të vitit akademik studentët e vitit të dytë njihen nga drejtuesi i departamentit të gjuhësisë ose koordinatori i programit të studimit me rregulloren e punimit të mikrotezës. Studentët ftohen të projektojnë fushën e tyre të interesit për punimin e mikrotezës në vijim të semestrit të parë. Në muajt dhjetor – janar studentëve të vitit të dytë ju kërkohet të plotësojnë formularin e kërkesës për temën dhe udhëheqësin, që ata propozojnë. Formularët e plotësuar i dorëzohen për diskutim departamentit. Departamenti ka tagrin të pranojë ose të ndryshojë temat e propozuara. Gjithashtu departamenti ka tagrin përfundimtar të përcaktimit të udhëheqësit, duke shpërndarë në mënyrë proporcionale përgjegjësinë e udhëheqjeve të diplomave (mikrotezave tani e më tej) brenda stafit akademik me kohë të plotë sipas fushave të tyre të ekspertizës. Udhëheqësi vlerëson progresin e studentit/studentes rregullisht dhe monitoron punën e tij përkundrejt standardit të kërkuar. UE ka hartuar edhe një format për punimin e diplomës dhe e ka publikuar në uebin e vet. [Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 3.10 Manuali i punimit të diplomës Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit)]



<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit, dhe nga takimi me studentët konstatohet se institucioni ndihmon studentët në realizimin e matjeve dhe analizave për punët e tyre kërkimore qoftë ato në nivel detyre kursi, qoftë për temën e mikrotezës. Institucioni gjithashtu ka nënshkruar disa marrëveshje me institucione të tjera të cilat u mundësojnë studentëve realizimin e matjeve dhe analizave, gjatë kërkimit shkencor në terren. Pedagogët shoqëruar në kërkimin gjuhësor në terren e asistojnë studentit përgjatë mbledhjes së materialit gjuhësor dhe regjistrimit të të dhënave. Departamenti ka hartuar pyetësonin e mbledhjes së të dhënave të natyrës gjuhësore dhe etnografike, që do ta drejtojnë studentin në mbledhjen sistematike të të dhënave për studim.</p> <p>[Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.35. Rregullore e Kërkimit Gjuhësor në Terren; Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (rregullorja e diplomimit)]</p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Vërejmë se mbrojtja e mikrotezës realizohet pranë komisionit. Komisioni i vlerësimit përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë, të cilët caktohen nga drejtuesi i departamentit dhe i përcillet Dekanit të Fakultetit për miratim. Anëtarët e komisionit duhet të kenë së paku gradën shkencore “Doktor”. Kryetar i komisionit është anëtari me titullin më të lartë akademik. Komisioni në përfundim të prezantimeve nga secili student, bën vlerësimin e punës së tyre me notë. Notat regjistrohen në procesverbalin përkatës të firmosura nga anëtarët e komisionit dhe u komunikohen studentëve.</p> <p>[Evidencat: 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”]</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në dokumentacion pohohet se studentët në përfundim të studimeve në MSHGJ pajisen me diplomën, certifikatën e notave dhe me suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Kopja zyrtare e programit të studimit u vihet në dispozicion studentëve në bazë të një kërkesë paraprake pranë Zyrës së Standardeve dhe Kurrikulave.</p> <p>[Evidenca 1.27 Shkresa e QSHA për miratimin e formatit të diplomës së programit të studimit. Modeli i diplomës të programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.28 Shkresa e QSHA për regjistrimin e diplomës së programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 3.12 Modeli i suplementit të diplomës të programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”]</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Sipas dokumentacionit bashkangjitur, konstatohet se UNIEL ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. Dokumentacioni i studentit ruhet në bazë të akteve ligjore në fuqi dhe në bazë të rregulloreve përkatëse nga sekretaria mësimore. Informacionet për studentin ruhen edhe në sistemin EMS. Njësia</p>



	<p>kryesore krijon dosjen e studentit që në çastin e regjistrimit, dosje e cila pasurohet më tej me të dhëna në sistemin elektronik dhe në regjistrat e sekretarisë mësimore.</p> <p>[Evidenca: 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; 2.5. Rregullore për ruajtjen, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit në UE “A.Xhuvani” https://ëëë.uniel.edu.al/universiteti-ue/legjislacion/akte-te-brendshme/1312-rregullore-per-krijimin-regjistrimin-ruajtjen-sherbimin-dorezimin-e-dokumentave-ne-universitetin-e-elbasanit-aleksander-xhuvani, Evidenca 4.11 Rregullorja EMS]</p>		
Konkluzione	<p><i>UE ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm. Studentët janë të mirëinformuar në çdo formë komunikimi.</i></p>		
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Nuk ka të dhëna për këtë kriter.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Nuk ka të dhëna për këtë kriter.
Kriteri 3. Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Nuk ka të dhëna për këtë kriter.


Konkluzione	<i>GVJ nuk mund të shprehet në lidhje me shkallën e përmbushjes së këtij standardi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	<p>Dokumentacioni që gjendet në dosje na bën të pohojmë se departamenti i gjuhësisë përbëhet nga një staf akademik me përvojë dhe tituj akademikë, ndër më të kualifikuarit në universitet dhe me veprimtari kërkimore të spikatur në fushat që lidhen me këtë program: gjuhësi dhe albanologji. Gjithashtu, pjesë e këtij programi janë edhe profesorë të njësive të tjera të fakultetit, si qendra e studimeve albanologjike dhe ballkanologjike “Aleks Buda” dhe departamenti i letërsisë dhe gazetarisë. Departamenti i gjuhësisë ka aktualisht 5 (pesë) personel akademik të kategorisë “Profesor”, prej të cilëve 1 (një) me titullin akademik “Profesor doktor” dhe 4 (katër) me titullin akademik “Profesor i asociuar”; 3 (tre) personel akademik të kategorisë “Lektor” me gradë shkencore “Doktor i shkencave”.</p> <p>[Tabela 1 - Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë; Tabela 2 - Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programin e studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Tabelat 6 - Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit; Tabela 7 - Të dhënat përmbledhëse të stafit akademik për “Master i shkencave në gjuhësi”, sipas kualifikimit dhe raportet midis tyre]</p>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit	Nga materiali i shqyrtuar në dosje, konstatojmë se ngarkesa mësimore e programit të studimit MSHGJ realizohet në masën më të madhe nga personeli i departamentit të gjuhësisë. Shpërndarja e ngarkesës mësimore të secilit pedagog në departamentin e gjuhësisë bëhet duke

<p>në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>zbatuar aktet nënligjore në fuqi, si Udhëzimi i MASR Nr.29, datë 10.09.2018, Nr.9268, dhe duke zbatuar rregullat e parashikuara në dokumentet ligjore të UE “A. Xhuvani”.</p> <p>[Tabela 2 - Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programin e studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Tabela 4 - Ngarkesa totale e personelit akademik të programit “Master i shkencave në gjuhësi” në një vit akademik; Tabelat 12 - Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Në dokumentacionin bashkangjitur pohohet se UE garanton dhe dëshmon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të përfshirë në programin e studimit, për të gjithë periudhën në të cilën do të bëhet akreditimi i programit të studimit MSHGJ. Përfshirja e personelit akademik, efektiv dhe me kontratë, në mësimdhënien e programit të studimit bëhet sipas dokumenteve rregullatore të UE-së. Administratori dhe drejtorja ekonomike e institucionit përgjigjen për pagesën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të personelit akademik e ndihmës akademik.</p> <p>[Evidenca 4.1 Listëpagesa e personelit janar-qershor 2022; Evidenca 4.2 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik UNIEL]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të konsultuar, vërejmë se UE ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetura në kritere të përgjithshme dhe specifike. Të gjitha njoftimet publikohen duke garantuar përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Departamenti i gjuhësisë, bazuar në aktet e brendshme normative, në procedurat e rekrutimit të personelit akademik, harton dhe bën publike kritere të përgjithshme dhe specifike, të cilat janë në përputhje me drejtimin dhe fushën e studimeve të departamentit. Këto kritere garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p>[4.2 Rregullore e modaliteteve të rekrutimit të personelit akademik UNIEL https://ëëë.uniel.edu.al/universiteti-ue/legjislacion/akte-te-brendshme/1311-rregullore-per-caktimin-e-kritereve-dhe-procedurave-per-punesimin-e-personelit-akademik-ne-universitetin-e-elbasanit-aleksander-xhuvani ; Evidenca 4.22 Kriteret për rekrutimin e personelit akademik me kohë të pjesshme (2021), departamenti i gjuhësisë; Tabela 2 - Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programin e studimit “Master i shkencave në gjuhësi”]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për</p>	<p>Nga konsultimi i dokumentacionit në dosjen për akreditim, vërejmë UE siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas</p>




<p>mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>natyrës specifike të programit të studimit. Por në programin e studimit MSHGJ nuk janë parashikuar laboratorë dhe kështu nuk kërkohet angazhim i personelit ndihmësakademik. Në ekspeditën që zhvillohet në kuadrin e Kërkimit Gjuhësor në terren pedagogët i shoqërojnë vetë studentët, duke i udhëzuar për mbledhjen e materialit, kontaktin me informatorin gjuhësor etj. [Evidenca 1.10 Struktura organizative e UNIEL; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.35. Rregullore e Kërkimit Gjuhësor në Terren; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi” (shqip e anglisht)]</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Konstatohet se UE mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Me fillimin e vitit akademik, departamenti i gjuhësisë përcakton pedagogët (lektorët dhe asistent pedagogët) që do të japin lëndët/modulet e programit të studimit, duke ruajtur profilin e secilit. Për këtë ai bashkëpunon edhe me departamentet e tjera të FSHH-së për lëndët/modulet e programit që mbulojnë ata. Drejtoria e Standardeve dhe Kurrikulave mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit efektiv dhe me kontratë të përfshirë në mësimdhënien e programit. Në departament ruhen kopjet e CV të gjithë pedagogëve që japin mësim në programet e studimit që mbulon ai. [Tabela 2 - Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programin e studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Tabela 4 - Ngarkesa totale e personelit akademik të programit “Master i shkencave në gjuhësi” në një vit akademik; Tabelat 12 - Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës; Evidenca 4.18 CV e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit “Master i shkencave në gjuhësi”]</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit bashkangjitur, pohojmë se UE ka nënshkruar marrëveshje të posaçme për realizimin e praktikave profesionale për programin e studimit. Me krijimin e Bordit Këshillimor të Biznesit, studentët janë përfshirë në aktivitete të shumta informuese për t’i njohur ata me kërkesat e punëdhënësve. UE ka të përcaktuara qartë, në strategjinë e vet të zhvillimit institucional, prioritetet e politikës së tij të bashkëpunimit. Këto prioritete reflektohen në marrëveshjet e bashkëpunimit me universitete të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe me institucione lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Institucioni ka zhvilluar partneritete me institucione të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit. Këto partneritete kanë sjellë si produkte organizimin e veprimtarive të përbashkëta të rëndësishme, si konferenca kombëtare e ndërkombëtare, aktivitete ndërkombëtare për sigurimin e cilësisë së IAL-ve, organizimin e aktiviteteve promovuese të</p>


	<p>mobiliteteve Erasmus+, trajnime e kualifikime të vazhduara për studentët etj.</p> <p>[Evidenca 1.13 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave; Evidenca 3.9 Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillimor të Biznesit 2021-2022; Tabela 5 - Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese në rang programi/esh studimi për Praktikrat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë]</p>		
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Konstatojmë se personeli mbikqyrës në ekspeditën që zhvillohet në kuadrin e Kërkimit Gjuhësor në terren janë pedagogë të përcaktuar sipas rregullores së Kërkimit Gjuhësor, dhe janë pedagogë edhe udhëheqës shkencorë të studentëve. Ata i shoqërojnë vetë studentët, duke i udhëzuar për mbledhjen e materialit, kontaktin me informatorin gjuhësor, regjistrimin e të dhënave, përdorimin e metodologjive të ndryshme dhe teknologjive të ndryshme në mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave etj.</p> <p>[Evidenca 1.33 Paketa e praktikës për programin e studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.35. Rregullore e Kërkimit Gjuhësor në Terren; evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Tabela 5 - Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese në rang programi/esh studimi për Praktikrat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti i gjuhësisë përbëhet nga një staf akademik me përvojë dhe tituj akademikë, ndër më të kualifikuarit në universitet dhe me veprimtari kërkimore të spikatur në fushat që lidhen me këtë program: gjuhësi dhe albanologji.</i></p> <p><i>Gjithashtu, pjesë e këtij programi janë edhe profesorë të njësive të tjera të fakultetit, si qendra e studimeve albanologjike dhe ballkanologjike “Aleks Buda” dhe departamenti i letërsisë dhe gazetarisë</i></p> <p><i>Sa më sipër GVJ shrehet se përmbushen plotësisht standardet sasiore dhe cilësore akademike në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

Standardi IV.2


Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Sipas dokumentacionit në dispozicion dhe vitës në UE, konstatohet se UE siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore.</p> <p>Departamenti i gjuhësisë ka në dispozicion një mjedis infrastrukturor të përshtatshëm për realizimin e këtij programi studimi. Sallat mësimore janë të pajisura me mjete bashkëkohore për t'u përdorur nga pedagogët dhe për të perfeksionuar procesin mësimor me mjetet teknologjike audiovizive etj. Sallat e leksioneve dhe auditorët e seminareve janë të pajisura me mjetet e nevojshme të teknologjisë së informacionit. Ato janë të pajisura me sisteme kondicionimi, me qëllim krijimin e kushteve sa më të përshtatshme të studentëve dhe pedagogëve. Fakulteti ka mjedise të përshtatshme dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin për kryerjen e detyrave në mënyrë profesionale. Në Fakultetin e Shkencave Humane ofrohet një normativë e pritshme prej 2m²/student.</p> <p>[Evidenca 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve të Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 4.20 Raporti i ekspertit për infrastrukturën (mbrojtja nga zjarri, higjiena, sigurimi i godinës)].</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Vërejmë se UE ofron për Fakultetin e Shkencave Humane mjediset mësimore të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p> <p>Auditorët në Fakultetin e Shkencave Humane janë të pajisura me tabela dhe mjetet e nevojshme didaktike. Departamenti ka në dispozicion të tij videoprojektorë, të cilët pedagogët i përdorin sipas nevojave. Sallat 107, dhe 311 janë të pajisura me gjitha kushtet e teknologjisë së informacionit.</p> <p>[Evidenca 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve të Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 4.20 Raporti i ekspertit për infrastrukturën (mbrojtja nga zjarri, higjiena, sigurimi i godinës)].</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të</p>	<p>Konstatohet se godinat e UE-së janë projektuar dhe ndërtuar që në mjediset e mësimdhënies të sigurohet akustika. Mjediset e mësimin janë izoluar nga zhurmat, luhatjet e temperaturës dhe lagështirës. Të gjitha godinat e UE-së kanë sistem ngrohjeje qendrore me kaldajë në çdo fakultet.</p>



objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	<p>Mjediset mësimore në Fakultetin e Shkencave Humane përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit.</p> <p>[Evidenca 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve të Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 4.20 Raporti i ekspertit për infrastrukturën (mbrojtja nga zjarri, higjiena, sigurimi i godinës)].</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>KONstatojmë se UE ka siguruar të paktën një laborator të teknologjisë së informacionit të pajisur me programe profesionale.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Humane ka në përdorim një laborator funksional të teknologjisë, për t'iu përgjigjur nevojave të studentëve kryesisht të programeve bachelor në gjuhët e huaja, por jo për studentët e MSHGJ. Në laboratorin e trashëgimisë kulturore (Salla 311) mungojnë pajisje, si diktofonë, skaner, aparat fotografik dhe video, kompjuterë, të cilat do të mundësonin një regjistrim më të mirë të të dhënave të terrenit.</p> <p>[Evidenca 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve të Fakultetit të Shkencave Humane]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Nuk ka të dhëna për këtë kriter.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UE siguron mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore.</i></p> <p><i>Departamenti i gjuhësisë ka në dispozicion një mjedis infrastrukturor të përshtatshëm për realizimin e këtij programi studimi. Sallat mësimore janë të pajisura me mjete bashkëkohore për t'u përdorur nga pedagogët dhe për të perfeksionuar procesin mësimor me mjetet teknologjike audiovizive etj. Sallat e leksioneve dhe auditorët e seminareve janë të pajisura me mjetet e nevojshme të teknologjisë së informacionit. Ato janë të pajisura me sisteme kondicionimi , me qëllim krijimin e kushteve sa më të përshtatshme të studentëve dhe pedagogëve. Fakulteti ka mjedis</i></p>




	<i>të përshtatshme dhe me mundësi të barabarta për të gjithë personelin për kryerjen e detyrave në mënyrë profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit dhe vizitës së bërë në ambientet fizike, konstatohet se studentët e UE-së kanë në dispozicion një fond librash në Bibliotekën e UE-së, që pasurohet për çdo vit. UE u ka vënë në dispozicion stafit akademik dhe studentëve përdorimin edhe të librarive elektronike ndërkombëtare. Fondi fizik i bibliotekës së universitetit për shkencat humane është 14935 tituj dhe 66480 kopje.</p> <p>Në Bibliotekën e UE-së ka një fond unik librash të albanologjisë, dhuratë e albanologut frëng Christian Gutt në dispozicion të stafit të departamentit dhe studentëve të MSHGJ.</p> <p>Në silabuset e lëndëve parashikohet literatura bazë dhe literatura ndihmëse, e cila përditësohet çdo vit akademik. Literatura e pasqyruar parashikohet në fondin e Bibliotekës, por edhe në burimet elektronike. Biblioteka e Universitetit është e pajisur me një fond të pasur në revista shkencore, periodikë, e në tituj të viteve të fundit.</p> <p>[3.8 Fondi i librit; evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library; Evidenca 3.19 Buxheti për pasurim të bibliotekës në vitin e fundit në nivel fakulteti (shih evidencën 1.11 për analizën vjetore institucionale); Evidenca 3.22 Blerjet e fundit të Bibliotekës]</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit në dispozicion, pohohet se UE pasuron në mënyrë të vazhdueshme literaturën e bibliotekës universitare në varësi të nevojave. Pasurim tjetër të literaturave përbën edhe lidhja online me biblioteka të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare. Biblioteka pasurohet shpesh edhe nga dhurimet e fondeve të librave për UE. UE parashikon çdo vit fonde për blerjen e literaturës së specializuar në fushën e kërkimit shkencor sipas propozimeve që vijnë nga departamentet e çdo fakulteti dhe në varësi të mundësive financuese. Departamenti i gjuhësisë dhe FSHH çdo vit paraqet kërkesat për botimet e reja në fushë të gjuhësisë për përditësimin e fondit të bibliotekës së universitetit.</p> <p>[3.8 Fondi i librit; evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library; Evidenca 3.19 Buxheti për pasurim të bibliotekës në vitin e fundit në</p>




	nivel fakulteti (shih evidencën 1.11 për analizën vjetore institucionale); Evidenca 3.22 Blerjet e fundit të Bibliotekës]
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	<p>Konstojmë se UE ka një bibliotekë universitare (pranë korpusit qendror) me degë në fakultete të ndryshme, e cila ka mjedise të mjaftueshme dhe mund të shfrytëzohet lirisht nga studentët që ndjekin këtë program studimi dhe kanë mundësi të konsultojnë librat e bibliotekës sipas orareve të këtij institucioni. Biblioteka ofron hapësira të dedikuara për studentët për leximin si dhe një fond të pasur të librave universitarë dhe literaturë ndihmëse plotësuese. Fondi i bibliotekës pasurohet herë pas here me anë të abonimeve në revista kombëtare e ndërkombëtare ku UE është abonuar, donacione dhe dhurime të fondit të bibliotekës.</p> <p>Fondi fizik i bibliotekës së universitetit për shkencat humane është 14935 tituj dhe 66480 kopje.</p> <p>Në Bibliotekën e UE-së ka një fond unik librash të albanologjisë, dhuratë e albanologut frëng Christian Gutt në dispozicion të stafit të departamentit dhe studentëve të MSHGJ.</p> <p>[3.8 Fondi i librit; evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library; Evidenca 3.19 Buxhetimi për pasurim të bibliotekës në vitin e fundit në nivel fakulteti (shih evidencën 1.11 për analizën vjetore institucionale); Evidenca 3.22 Blerjet e fundit të Bibliotekës; Evidenca 4.10 Të dhëna mbi orarin e shërbimit të Bibliotekës UNIEL]</p>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	<p>Pohojmë se në përgjithësi Biblioteka e Universitetit është e pasur me tekste universitare, libra e revista shkencore në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Ajo ka një fond fizik të pasur, ku përfshihen tekste mësimore bazë, literaturë mbështetëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore të parashikuara në MSHGJ. Në Bibliotekën e UE-së ka një fond unik librash të albanologjisë, dhuratë e albanologut frëng Christian Gutt në dispozicion të stafit të departamentit dhe studentëve të MSHGJ. Në këtë fond, ka botime në fushë të albanologjisë, ballkanologjisë, dhe disiplinave të ndryshme të gjuhësisë.</p> <p>[3.8 Fondi i librit; evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library; Evidenca 3.19 Buxhetimi për pasurim të bibliotekës në vitin e fundit në nivel fakulteti (shih evidencën 1.11 për analizën vjetore institucionale); Evidenca 3.22 Blerjet e fundit të Bibliotekës; Evidenca 4.10 Të dhëna mbi orarin e shërbimit të Bibliotekës UNIEL]</p>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	KONstatojmë se Universiteti i Elbasanit ka krijuar kushte që, nëpërmjet adresës elektronike, studentët të kenë qasje në revistat dhe botimet elektronike botërore të renditura në JStore.

	[3.8 Fondi i librit; evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library; Evidenca 3.19 Buxhetimi për pasurim të bibliotekës në vitin e fundit në nivel fakulteti (shih evidencën 1.11 për analizën vjetore institucionale); Evidenca 3.22 Blerjet e fundit të Bibliotekës]
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Vërejmë se biblioteka i ka kushtet teknike. Në bibliotekë ekziston salla e kompjuterëve, e cila shfrytëzohet nga studentët për të kryer kërkime të literaturës dhe të ndërtimit të njësisë. Universiteti po krijon mundësinë e digjitalizimit të fondit të bibliotekës së universitetit, në mënyrë që kushdo të ketë qasje në literaturë. [Evidenca 3.7 Anëtarësimi në JSTORE dhe U-Library; 4.9 Dokumenti për njoftimin e projektit për digjitalizimin e Bibliotekës UNIEL; 4.10 Të dhëna mbi orarin e shërbimit të Bibliotekës UNIEL]
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Vërejmë se Biblioteka qendrore e UE-së vë në dispozicion të studentëve fondin e saj në orare shërbimi, që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre. Oraret e punës së bibliotekës në UE, gjatë të cilave punonjësit u përgjigjen nevojave të studentëve, janë të shpallura në mjediset e bibliotekës. Studentët që shfrytëzojnë bibliotekën pajisen me një kartelë regjistrimi përmes së cilës studenti siguron literaturën. Në të ardhmen, janë planifikuar edhe kartat elektronike të bibliotekës. [Evidenca 4.10 Të dhëna mbi orarin e shërbimit të Bibliotekës UNIEL]
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Konstatojmë se të dhënat mbi cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. Biblioteka ka një staf të plotë, me të gjitha strukturat e nevojshme të një biblioteke universitare. Fondi fizik i bibliotekës së universitetit për shkencat humane është 14935 tituj dhe 66480 kopje. [Evidenca 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021]
Konkluzione	<i>GVJ shprehet se studentët kanë në dispozicion një fond librash në Bibliotekën e UE-së, që pasurohet për çdo vit. Fondi fizik i bibliotekës së universitetit për shkencat humane është 14935 tituj dhe 66480 kopje. Në Bibliotekën e UE-së ka një fond unik librash të albanologjisë, dhuratë e albanologut frëng Christian Gutt në dispozicion të stafit të departamentit dhe studentëve të MSHGJ.</i>

	<p>Në silabuset e lëndëve parashikohet literatura bazë dhe literatura ndihmëse, e cila përditësohet çdo vit akademik.</p> <p>Biblioteka e Universitetit është e pajisur me një fond të pasur në revista shkencore, periodikë, e në tituj të viteve të fundit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet se UE disponon një sistem të menaxhimit elektronik dhe në letër/dokument (në regjistrat e sekretarisë së fakultetit) të të dhënave, nëpërmjet të cilit administrohet të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe veprimtarinë e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p> <p>Universiteti disponon sistemin elektronik të të dhënave, EMS, eeë.uniel.ems.al si dhe një rregullore të funksionimit të tij. Në këtë sistem kanë profilin e tyre dhe akses të gjithë studentët, i gjithë stafi akademik efektiv dhe me kontratë. Gjithashtu, institucioni u ka vënë në shërbim të gjithë studentëve dhe stafit akademik (PAE dhe PAK) adresat e emailit zyrtare (me @uniel.edu.al), i cili shërben për komunikimin e brendshëm institucional, por edhe të jashtëm.</p> <p>[Evidencat: 4.11 Rregullorja EMS; Evidenca 1.15 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH-së]</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrohet informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit pohohet se në sistemin EMS, në regjistrat e sekretarisë dhe në zyrat e sekretarisë së titullarit të njësive kryesore (fakultetit) pasqyrohen, administrohen dhe ruhen të dhëna dhe informacione, dokumentacione dhe aktivitetet e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ.</p> <p>Këto të dhëna përfshijnë dokumentacione të studentëve që ndjekin studimet në UE dhe të dhëna për vlerësimet e marra nga studentët gjatë periudhës së studimit, të dhëna për personelin akademik, ndihmësakademik dhe administrative, programe studimi, plane mësimore (kurrikula, disiplinat e lëndëve dhe moduleve), të dhëna për tarifën e shkollimit dhe pagesat e kryera nga studentët.</p> <p>[Evidenca Evidenca 2.5 Rregullore për ruajtjen, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit në UE "A.Xhuvani"]</p>

	https://ëëë.uniel.edu.al/universiteti-ue/legjislacion/akte-te-brendshme/1312-rregullore-per-krijimin-regjistrimin-ruajtjen-sherbimin-dorezimin-e-dokumentave-ne-universitetin-e-elbasanit-aleksander-xhuvani]
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	KONstatojmë se sistemi EMS u jep mundësi pedagogëve të ngarkojnë në sistem materiale ndihmëse për studentët. Veç sistemit EMS, pedagogët e universitetit në komunikimin me studentët përdorin edhe adresat zyrtare të postës elektronike @uniel.edu.al, të cilat ofrohen edhe për studentët. Përgjatë periudhës së Pandemisë Covid-19 i gjithë sistemi i mësimdhënies akademike u realizuar me Microsoft Teams, i cili mund të përdoret ende më tej për dhënien e materialeve teorike (literaturë, leksione për studentët, video etj.) [Evidencat: 4.11 Rregullorja EMS; Evidenca 6.1 <u>Guida e pedagogut: Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams</u>]
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Vërejmë se sistemi EMS ka të përfshira në kapacitetet e veta komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacioneve të tjera, por këto nuk janë ende të aktivizuara. Përgjatë periudhës së Pandemisë Covid-19 i gjithë sistemi i mësimdhënies akademike u realizuar me Microsoft Teams, i cili mund të përdoret ende më tej për shkëmbimin e informacioneve dhe dhënien e materialeve teorike (literaturë, leksione për studentët, video etj.). [Evidencat: 4.11 Rregullorja EMS; Evidenca 6.1 <u>Guida e pedagogut: Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams</u>]
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Nga dokumentacioni, konstatojmë se autoritetet drejtuese, rektor, dekan, drejtues i njësisë bazë dhe sekretaria mësimore kanë të drejtë të monitorojnë në kohë reale të dhënat dhe raportet e gjeneruara nga sistemi EMS mbi kalueshmërinë, frekuentimin etj. [Evidencat: 4.11 Rregullorja EMS]
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Konstatojmë se UE publikon në ëëësit-in zyrtar (ëëë.uniel.edu.al) informacione që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme. Në faqen zyrtare në internet të universitetit publikohen të dhënat kryesore për MSHGJ (https://uniel.edu.al/fakultetet/fakulteti-i-shkencave-humane/programet-e-studimit), aktivitetet e departamentit dhe të Fakultetit të Shkencave Humane. Ndërsa veç faqes në internet departamenti i gjuhësisë ka në përdorim edhe llogari në facebook (https://ëëë.facebook.com/profile.php?id=100063825691085) dhe instagram (https://ëëë.instagram.com/gjuhesiaelbasan/), të cilat i përdor si kanale informuese për publikun dhe për studentët. [4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen EEB]




Konkluzione	<p><i>UE disponon një sistem të menaxhimit elektronik dhe në letër/dokument (në regjistrat e sekretarisë së fakultetit) të të dhënave, nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe veprimtarinë e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</i></p> <p><i>Universiteti disponon sistemin elektronik të të dhënave, EMS, www.uniel.ems.al si dhe një rregullore të funksionimit të tij. Në këtë sistem kanë profilin e tyre dhe akses të gjithë studentët, i gjithë stafi akademik efektiv dhe me kontratë. Gjithashtu, institucioni u ka vënë në shërbim të gjithë studentëve dhe stafit akademik (PAE dhe PAK) adresat e emailit zyrtare (me @uniel.edu.al), i cili shërben për komunikimin e brendshëm institucional, por edhe të jashtëm</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Konstatohet se Universiteti i Elbasanit ka hartuar raportin financiar të kostove të programit të studimit dhe ofron planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit MSHGj.</p> <p>Po kështu, vërejmë se për hartimin e këtij raporti financiar kujdeset Drejtoria Ekonomike, e cila ua vë në dispozicion departamenteve përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p>[Evidenca 1.10 Struktura organizative e UNIEL dhe e FSHH-së; Evidenca 4.16 Të dhëna që lidhen me koston e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi]</p>



<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, vërejmë se plani i financimit të departamentit të gjuhësisë për programin e studimit MSHGJ përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare etj. Ky raport hartohet nga Drejtoria Ekonomike, e cila ua vë në dispozicion departamenteve përgjegjëse për programin e studimit.</p> <p>[Evidenca 1.10 Struktura organizative e UNIEL dhe e FSHH-së; Evidenca 4.16 Të dhëna që lidhen me koston e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Vërejmë se UE i nënshtrohet vazhdimisht auditimit periodik të bazuar mbi dokumentacionet e transaksioneve ekonomike e financiare. UE analizon në mënyrë periodike treguesit e monitorimit të zbatimit të politikës financiare, nëpërmjet rishikimit periodik të buxhetit dhe rialokimit të fondeve sa herë lind nevoja.</p> <p>[Evidenca 4.13 Raporti i Auditit KLSH 2022]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Në dosje pohohet se njësitë bazë dhe njësitë kryesore në UE nuk kanë administrator, ndaj raportimet financiare nuk realizohen në nivel të njësisë bazë apo kryesore, por në nivel institucional.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Sipas dokumentacionit, vërejmë se UE garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të departamentit dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të programeve të studimit që realizon. Rezultatet e auditimit financiar të UE-së bëhen publike sipas përcaktimeve në dispozitat ligjore në varësi të llojit të auditimit dhe subjektit auditues. Pas analizave dhe diskutimeve në strukturat përkatëse, raporti i auditimit financiar diskutohet në organet kolegjiale dhe bëhet publike. Institucioni harton çdo vit një relacion për planin buxhetor të institucionit.</p> <p>[Evidenca 4.14 Miratimi i Buxhetit 2021 dhe Buxhetit 2022; evidenca 4.15 Miratimi i regjistrit të prokurimeve dhe shërbimeve.]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Plani i financimit të departamentit të gjuhësisë për programin e studimit MSHGJ përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e</i></p>




	<p><i>mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare etj.</i></p> <p><i>Ky raport hartohet nga Drejtoria Ekonomike, duke garantuar dhe mbështetje financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE


Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit, konstatojmë se UE “Aleksandër Xhuvani” harton dhe zbaton procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> <p>FSHH i pajis studentët me të gjitha materialet e nevojshme informuese si broshura, i adreson në faqen ueb dhe i informon në lidhje me çdo mjet tjetër komunikimi. Rregullorja e studimeve në UE, e FSHH-së dhe e departamentit të gjuhësisë përcakton mënyrën dhe kohën se kur studenti e fiton statusin e tij dhe kur e humbet atë. Qysh nga koha kur studenti e ka fituar statusin e tij e deri në përfundim të studimeve të tij në MSHGJ, studenti ndiqet dhe mund të pajisjet me çdo informacion të nevojshëm jo vetëm në departament por edhe në sekretarinë mësimore.</p> <p>[Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”]</p>



<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit, mund të pohojmë se pranimi dhe regjistrimi i studentëve në programin e studimit MSHGJ bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Në Rregulloren e departamentit të gjuhësisë përcaktohen kriteret e pranimit të studentëve në programin e ciklit të dytë të studimeve MSHGJ. Politikat që ndiqen në departamentin e gjuhësisë të cilat shoqërojnë studentët nga hyrja e tyre në fakultet e deri në diplomimin e tyre bazohen në Rregulloren e UE, Rregulloren e FSHH etj. Këto rregullore garantojnë barazi për të gjithë studentët që ndjekin studimet në FSHH, edhe për studentët e MSHGJ.</p> <p>Politikat që garantojnë barazinë dhe të drejtat e të gjithë studentëve për një arsim cilësor dhe në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë, realizohen nëpërmjet informimit të plotë të studentëve në çdo kërkesë legjitime të tyre lidhur me programin e studimit, procesin mësimor, mënyrën e vlerësimit, rregulloren e departamentit, procesin e diplomimit etj.</p> <p>[Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.15 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH-së]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Nga shqyrtimi I dokumentacionit pohojmë se studentët që ndjekin studimet në programin e studimit të ciklit të dytë MSHGJ të departamentit të gjuhësisë përzgjidhen dhe pranohen sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloren e FSHH-së dhe departamentit.</p> <p>Studentët të cilët mund të jenë të interesuar, mund të marrin informacion të plotë rreth procedurave të përzgjedhjes, të pranimit, ndjekjes së studimeve, të transferimit, njohjes së studimeve, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit në programin e studimit të ciklit të dytë MSHGJ.</p> <p>Informacionet e nevojshme gjithashtu janë të aksesueshme edhe në ëebsit-in e UE-së, ku palët e interesuara mund të marrin informacionin që dëshirojnë rreth këtyre procedurave por gjithashtu informacione mund të merren edhe nga broshurat informuese që publikon dhe shpërndan departamenti në faqen e vet të Facebook-ut, Instagramit.</p> <p>[Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane https://ëëë.uniel.edu.al/images/studio_ne_ue/fakulteti_i_shkencave_humane/njoftime/Rregullore_e_FSHH.pdf Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.20 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit; Evidenca 1.21 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit]</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit,</p>	<p>Pohojmë se përpara fillimit të çdo viti akademik departamenti i gjuhësisë, me miratimin edhe të dekanit të FSHH-së, Senatit të UE-së harton dhe</p>




<p>njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>publikon kriteret e veçanta dhe specifike për t'u pranuar në programin e studimit të ciklit të dytë të studimeve MSHGJ.</p> <p>Informacionet e nevojshme janë të aksesueshme në uebsitin e UE-së, por gjithashtu informacione mund të merren edhe nga broshurat informuese që publikon dhe shpërndan departamenti në faqen e vet të Facebook-ut, Instagramit.</p> <p>[Evidenca 1.20 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit; Evidenca 1.21 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit; Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen ËEB]</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Konstatohet se përpara fillimit të çdo viti akademik, UE informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p> <p>Përpara fillimit të çdo viti akademik departamenti i gjuhësisë dhe FSHH-ja shpall publikisht në mjediset e FSHH-së dhe në sekretarinë mësimore përkatëse kriteret për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve MSHGJ. Gjithashtu informacionet publikohen edhe në uebsitin zyrtar të UNIEL-it dhe faqet në Facebook dhe Instagram të departamentit.</p> <p>[Evidenca 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane Evidenca 1.15 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH-së; Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen ËEB]</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>Konstatohet se UE parashikon kuota të posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p> <p>[Evidenca 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023]</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit , pohojmë se UE harton dhe publikon kriteret dhe përzgjedhjen për kandidatët nga shtetet e tjera mbi bazën e propozimeve që vijnë nga departamentet përkatëse. Deri tani, departamenti i gjuhësisë ka parashikuar kuota vetëm për kandidatë nga trevat shqipfolëse jashtë Republikës së Shqipërisë.</p> <p>[Evidenca 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023]</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Vërejmë se UE, në fillimin e çdo viti akademik, realizon procedurat përkatëse të ndihmës dhe bursave për shtresat në nevojë dhe për studentë ekselentë, sipas vendimit të Bordit të Administrimit UNIEL.</p> <p>[2.1 Vendimi i Bordit të Administrimit për bursat dhe përjashtimet].</p>



Konkluzione	<p>UE "Aleksandër Xhuvani" harton dhe zbaton procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p> <p>FSSH i pajis studentët me të gjitha materialet e nevojshme informuese si broshura, i adreson në faqen ueb dhe i informon në lidhje me çdo mjet tjetër komunikimi. Rregullorja e studimeve në UE, e FSSH-së dhe e departamentit të gjuhësisë përcakton mënyrën dhe kohën se kur studenti e fiton statusin e tij dhe kur e humbet atë. Qysh nga koha kur studenti e ka fituar statusin e tij e deri në përfundim të studimeve të tij në MSHGJ, studenti ndiqet dhe mund të pajisjet me çdo informacion të nevojshëm jo vetëm në departament por edhe në sekretarinë mësimore.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X


Standardi V.2 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>KONstatojmë se UE vë në dispozicion të studentëve dhe çdo pale të interesuar informacion të plotë dhe të hollësishëm për përparimin akademik të studentëve si dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin. Pranë mjediseve të UE-së është ngritur dhe funksionon zyra e Këshillimit dhe Karrierës, e cila ka si funksion edhe dhënien e informacionit të hollësishëm për studentët.</p> <p>Po kështu sekretaria mësimore e FSSH-së, dekanati i FSSH-së, si edhe vetë departamenti i gjuhësisë, nëpërmjet kontakteve me studentët, jep informacion të plotë për procedurat dhe kriteret për përparimin akademik të tyre dhe kalimin nga një vit akademi në tjetrin.</p> <p>[Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit "Master i shkencave në gjuhësi"; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë; Evidenca 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në dosje pohohet se sipas rastit dhe kur lind nevoja, UE informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Kjo realizohet nëpërmjet Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë.</p> <p>Në departament ngrihen një komision i posaçëm, i cili ekuivalenton dhe njej rezultate të arritura në kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, dhe këto e njohje e bën mbi bazën e dokumenteve</p>



	<p>përbajtjesore, si plani mësimor dhe programet e lëndëve, si dhe procedurat e parashikuara në rregulloret e studimeve të institucionit.</p> <p>[Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet se departamenti i gjuhësisë dhe çdo pedagog që jep mësim në MSHGJ, bazuar në Rregulloren e studimeve të UE-së dhe të FSHH-së, si dhe në Rregulloren e Departamentit të Gjuhësisë jep informacion për studentët lidhur me vlerësimin e tyre për lëndët që ata japin në këtë program studimi, duke i paraqitur silabusin e lëndës/modulit përkatës. Për secilën lëndë në programin e studimit të ciklit të dytë të studimeve MSHGJ, pedagogët titullarë dorëzojnë sipas Rregullores së UE pranë Zyrës së Kurrikulave planet dhe programet mësimore (Silabuset) në të cilat përcaktohet në mënyrë të hollësishme procedura dhe kriteret e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve.</p> <p>[Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi” (shqip e anglisht); Evidenca 3.17 Programet mësimore të lëndëve të programit të studimit (silabuset, në shqip dhe anglisht) “Master i shkencave në gjuhësi”; Tabela 15 - Format e kontrollit të njohurive]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit të programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet se në programet e ciklit të dytë të studimit MSHGJ studenti diplomohet me punim diplome një mikrotezë. Në fillim të vitit të fundit të studimeve departamenti i gjuhësisë përcakton fushat e studimit për punimet e mikrotezave. Mikroteza bëhet duke mbajtur në konsideratë udhëzimet në Manualin e Punimit të Diplomës, i cili miratohet nga FSHH-ja dhe iu bëhet i njohur studentëve nga departamenti i gjuhësisë ose koordinatori i programit të studimit. Studentët informohen lidhur me kriteret dhe procedurat e diplomimit të tyre edhe nga sekretaria mësimore.</p> <p>[Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 3.10 Manuali i punimit të diplomës; Evidenca 3.11 Paketa e punimit të diplomës për programin e studimit (Rregullorja e diplomimit)]</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet se UE organizon takime të hapura për informimin e maturantëve dhe kandidatëve të tjerë të interesuar për programet e studimit në UE. UE ka publikuar një spot promovues për programet e studimit që ofron dhe fletëpalosje promovuese, një prej tyre e hartuar edhe nga departamenti i gjuhësisë, me programet që ofron, në të tria ciklet e studimit. Në vitin e fundit të studimeve Bachelor grupe pune të ngritura nga departamenti (pedagogë të departamentit të gjuhësisë) informojnë studentët lidhur me kriteret e regjistrimit të tyre në programin MSHGJ</p>


	<p>në FSHH. Sekretaria mësimore e FSHH-së shërben gjithashtu si burim informacioni për studentët e ardhshëm për programin e studimit MSHGJ.</p> <p>[Evidenca 5.2 Kalendar i ditëve të hapura 2022; evidenca 5.3 Publikimi i spotit promovues; evidenca 5.4 Fletëpalosjet promovuese institucionale dhe të departamentit të gjuhësisë; Evidenca 1.15 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH-së].</p>		
Konkluzione	<p><i>UE vë në dispozicion të studentëve dhe çdo pale të interesuar informacion të plotë dhe të hollësishëm për përparimin akademik të studentëve si dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin. Pranë mjediseve të UE-së është ngritur dhe funksionon zyra e Këshillimit dhe Karrierës, e cila ka si funksion edhe dhënien e informacionit të hollësishëm për studentët.</i></p> <p><i>Po kështu sekretaria mësimore e FSHH-së, dekanati i FSHH-së, si edhe vetë departamenti i gjuhësisë, nëpërmjet kontakteve me studentët, jep informacion të plotë për procedurat dhe kriteret për përparimin akademik të tyre dhe kalimin nga një vit akademi në tjetrin</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Pohojmë se departamenti i gjuhësisë, përmes koordinorit të programit të studimit, informon studentët lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit të ciklit të dytë të studimeve MSHGJ.</p> <p>Informacioni për studentët lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e këtij programi studimi ofrohen edhe nga UE në uebsitin përkatës (ëëë.uniel.edu.al), nga dekanati i FSHH-së, nga departamenti i gjuhësisë, gjithashtu edhe nga sekretaria mësimore e FSHH-së.</p> <p>[Evidenca 1.18 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.23 Përshkrimi i detyrave të koordinorit të programit të studimit; Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen ËEB]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/</p>	<p>Konstatojmë se UE vë në dispozicion të studentëve informacionin, dokumentacionin dhe udhëzues të posaçëm për lëndët dhe veprimtarinë formuese. Studenti i akseson të dhënat edhe nëpërmjet profilit dhe</p>



<p>udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Ilogarisë që ka në EMS. Gjithashtu informacioni gjendet i publikuar në faqen ueb të institucionit, sipas zërave përkatës. Studentët asistohen gjatë gjithë kohës nga sekretaria mësimore. Po ashtu, plani mësimor i programit të studimit afishohet pranë mjediseve të FSHH-së, dhe është i disponueshëm për çdo ditë të vitit akademik të MSHGJ-së.</p> <p>Koordinatori i programit të studimit të ciklit të dytë MSHGJ ka si detyrë funksionale të tij gjithashtu të mbajë lidhje të qëndrueshme me studentët dhe t'u japë informacione lidhur me planet mësimore dhe programet e lëndëve dhe moduleve si dhe veprimtaritë formuese.</p> <p>[Evidenca 4.11 Rregullorja EMS; Evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen ËEB; Evidenca 3.16 Plani mësimor i programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi” (shqip e anglisht)]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Konstatohet se Zyra e Këshillimit, Karrierës dhe ALUMNI ka si detyrë funksionale në UE dhënien e informacionit për studentët e UE-së për sa i përket mundësive të punësimit, mënyrën se si mund të plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm, t'i orientojë lidhur me studimet që duhet të ndjekin në vazhdim për t'u punësuar në punën e dëshiruar, apo për të përpunuar në karrierë në punën ku janë të punësuar për studentët e nivelit Master etj. Gjithashtu statistikat e punësimit real të studentëve i ndihmojnë ata në orientimin e punësimit të ardhshëm të tyre bazuar edhe në mundësitë që ofrojnë njësitë publike dhe private por gjithashtu edhe në kërkesat e punësimit të publikuara nga këto njësi, informacion që studentët e marrin jashtë FSHH-së.</p> <p>Studimi i tregut i realizuar nga Departamenti i Gjuhësisë ka ndihmuar për orientimin e studentëve rreth mundësive të punësimit dhe karrierës. Strategjia e programi të studimit MSHGJ, dhe vetë Koordinatori i programit të studimit MSHGJ informon studentët se cilat janë hapësirat e punësimit të tyre nëse ndjekin këtë program studimi.</p> <p>Studentët përfitojnë nga program i nxitjes së punësimit.</p> <p>[Evidenca 1.34 Politika e marketingut për programin e studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 5.15 Pyetësori i Alumnit zhvilluar nga departamenti i gjuhësisë; Evidenca 5.6 Të dhëna mbi studentët përfitues të programit të nxitjes së punësimit]</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit pohojmë se studentët e programit të studimit MSHGJ marrin informacion të plotë mbi zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Orari mësimor i MSHGJ, ku janë të pasqyruara orët, klasat, pedagogët përgjegjës, afishohet nga sekretaria mësimore e FSHH-së përpara se të fillojë viti akademik. Ai gjithashtu u jepet në formë elektronike studentëve nga drejtuesi i departamentit ose koordinatori i programit.</p> <p>Koordinatori i programit të studimit MSHGJ në detyrat funksionale të tij ka edhe detyrën e informimit të studentëve lidhur me zhvillimin dhe</p>


	<p>organizimin e procesit mësimor dhe komunikon me studentët lidhur me ndryshimet, nevojat, problematikat, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme.</p> <p>Çdo pedagog ka parashikuar në programin e lëndës përveç të tjerash edhe logjistikën që do t'i duhet për organizimin e lëndës përkatëse si dhe infrastrukturën e nevojshme.</p> <p>[Evidenca 1.15 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH-së; Evidenca 1.23 Përshkrimi i detyrave të koordinatorit të programit të studimit; Evidenca 4.6 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit të Shkencave Humane]</p>		
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Vërejmë se UE prej disa vitesh tashmë ka në funksionim një sistem elektronik të menaxhimit të brendshëm (EMS) në të cilën studentët dhe të interesuar të tjerë mund të informohen në mënyrë të vazhdueshme. Në mënyrë që të aksesojnë një informacion më të plotë dhe të detajuar në momentin që studentët e UE-së marrin këtë status, ata pajisen me një llogari të tyre dhe me një kod për të aksesuar lehtësisht informacionin personal dhe çfarë u takon për sa u përket lëndëve të shlyera apo jo, vlerësimit përkatës etj.</p> <p>Çdo student informohet nga sekretaria mësimore e FSHH-së se duhet të pajisen me informacionin për llogarinë e tyre dhe për çdo paqartësi dhe nevojë për informacion të mëtejshëm ata kontaktojnë me personat përgjegjës që merren me administrimin e sistemit.</p> <p>[Evidenca 4.11 Rregullorja EMS; evidenca 4.12 Të dhëna mbi publikimin në faqen ËEB). https://ëëë.uniel.edu.al/images/zona_padagogjike/UNIEL_MS_Teams_teacher_manual_AL.pdf</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti i gjuhësisë, përmes koordinatorit të programit të studimit, informon studentët lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit të ciklit të dytë të studimeve MSHGJ. Studentët e programit të studimit MSHGJ marrin informacion të plotë mbi zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. UE prej disa vitesh tashmë ka në funksionim një sistem elektronik të menaxhimit të brendshëm (EMS) në të cilën studentët dhe të interesuar të tjerë mund të informohen në mënyrë të vazhdueshme.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>




Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet se në FSHH dhe në sekretarinë mësimore të këtij fakulteti mbahet dhe ruhet dokumentacioni i procesit mësimor, si statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Gjithashtu punonjësit e Drejtorisë së Standardeve dhe të Sigurimit të Cilësisë pranë rektoratit të UE-së mbajnë statistika të plota dhe të hollësishme lidhur numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit të ciklit të dytë MSHGJ. Por edhe departamenti i gjuhësisë ka statistika për studentët dhe për të diplomuarit e këtij programi studimi. Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI asiston në gjurmimin e studentëve. Kjo njësi ka krijuar një databazë të të dhënave të gjurmimit të studentëve, e cila përditësohet me të dhëna çdo vit.</p> <p>[Evidenca 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021/2021-2022; Tabela 23 - Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Vërejmë se sekretaria mësimore e FSHH-së disponon të dhëna të plota lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, të tërhequr, të transferuar apo që nuk ka përfunduar me sukses vitin akademik në programin e studimit të ciklit të dytë MSHGJ. Gjithashtu, të gjitha të dhënat vjetore i dërgohen si informacion i hollësishëm Drejtorisë së Standardeve për qëllime statistikore, dhe i vihen në dispozicion departamentit sa herë kërkohen.</p> <p>[Evidenca 1.15 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH-së; Tabela 25 – Të dhëna tabelore për transferimin e studentëve të programit]</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit pohojmë se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të informacionit nga dy struktura përkatëse: Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe nga Drejtoria Ekonomike. Sekretaria mësimore në FSHH disponon të dhëna të hollësishme në regjistrin bazë lidhur me ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit MSHGJ. Sekretaria mësimore e FSHH-së është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të studentëve, për rregullimin, monitorimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti ose transkripti lidhur me studentët. Të dhënat në regjistrat e saj lehtësisht të verifikueshme dhe të disponueshme për personat e autorizuar. Në kuadër të ruajtjes së informacionit personal të studentëve, informacioni i marrë ruhet në mënyrë konfidenciale dhe shpërndahet vetëm për palët e autorizuar në plotësim të kriteve që përcaktohen në</p>



	<p>ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale” si dhe në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore për Arsimin e Lartë si dhe në bazë të Rregulloreve të funksionimit të UE.</p> <p>[Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 1.15 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH-së; Evidenca 2.5 Rregullore për ruajtjen, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit në UE “A.Xhuvani” https://ëëë.uniel.edu.al/universiteti-ue/legjislacion/akte-te-brendshme/1312-rregullore-per-krijimin-regjistrimin-ruajtjen-sherbimin-dorezimin-e-dokumentave-ne-universitetin-e-elbasanit-aleksander-xhuvani]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësisve përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Konstatohet se Rektori dhe drejtoritë përkatëse që lidhen me organizimin e punës në universitet kryejnë kontrolle periodike (auditim të brendshëm) pranë sekretarive mësimore dhe departamenteve për menaxhimin e informacioneve dhe dokumentacioneve (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), ku vlerësohet dhe dokumentohet gjendja dhe saktësia e informacionit dhe dokumentacionit të ruajtur dhe sistemuar.</p> <p>[Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 1.15 Modalitetet e organizimit dhe funksionimit të sekretarisë mësimore të FSHH-së; Evidenca 2.5 Rregullore për ruajtjen, administrimin dhe arkivimin e dokumentacionit në UE “A.Xhuvani” https://ëëë.uniel.edu.al/universiteti-ue/legjislacion/akte-te-brendshme/1312-rregullore-per-krijimin-regjistrimin-ruajtjen-sherbimin-dorezimin-e-dokumentave-ne-universitetin-e-elbasanit-aleksander-xhuvani]</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Vërejmë se departamenti i gjuhësisë merr informacion të plotë nga sekretaria mësimore e FSHH-së lidhur me cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje të studentëve për programin e studimit MSHGJ, si dhe cilësinë e punësimit të tyre dhe harton raportin vjetor të analizës së punës mësimore dhe shkencore, ku raportohet për cilësinë e studentëve në provime, numrin e të diplomuarve dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p> <p>[Evidenca 1.29 Raport për veprimtarinë e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi” për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 1.32 Analiza vjetore e departamentit të gjuhësisë 2020-2021; Evidenca 1.34 Politika e marketingut për programin e studimit “Master i shkencave në gjuhësi”]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në FSHH dhe në sekretarinë mësimore të këtij fakulteti mbahet dhe ruhet dokumentacioni i procesit mësimor, si statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Departamenti i gjuhësisë merr informacion të plotë nga sekretaria mësimore e FSHH-së lidhur me cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje</i></p>




	të studentëve për programin e studimit MSHGJ, si dhe cilësinë e punësimit të tyre dhe harton raportin vjetor të analizës së punës mësimore dhe shkencore, ku raportohet për cilësinë e studentëve në provime, numrin e të diplomuarve dhe cilësisë së punësimit të tyre		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit, pohojmë se UE nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre. Studentët janë të angazhuar në Senatin Akademik UNIEL. Studentët janë organizuar në Këshillin Studentor dhe kanë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tyre.</p> <p>Në përputhje me rregulloret e UE-së si dhe me rregulloren e brendshme të FSHH-së dhe departamentit të hjuhësisë, përfaqësues të studentëve janë të përfshirë në komisionet e ngritura në FSHH dhe në UE. Ata gëzojnë të drejtën e pjesëmarrjes në këto komisione, të përcjelljes së problematikave të studentëve, të diskutimit, si edhe të drejtën e votës. Studentët kanë të drejtë të organizohen në këshilla studentore në nivel njësie kryesore dhe nivel institucioni, si p.sh.:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit i ngritur pranë UE-së; • Komisioni për marrëdhëniet me studentët dhe këshillimin e karrierës; • Komisioni për garantimin e standardeve të cilësisë të njësisë bazë dhe programeve të studimit; • Komisioni për mbrojtjen e studenteve; • Senatin akademik të UE-së (dy anëtarë). <p>[Evidenca 2.2 Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL; Evidenca 2.3 Rregullore e Këshillit Studentor; Tabela 24 - Të dhëna për anëtarët e NJBSC]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Në dosje pohohet se në çdo mbledhje të organizuar nga komisionet e zgjedhura në UE dhe FSHH, përfaqësuesit e studentëve janë të pranishëm dhe kanë pasur të drejtën e tyre të votimit ose të vendimit. UE garanton përfshirjen e studentëve ose përfaqësuesve të tyre në organizmat universitarë. Studentët janë të angazhuar në Senatin Akademik UNIEL Studentët janë organizuar në Këshillin Studentor dhe kanë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tyre. Studentët kanë përfaqësuesin e tyre në Komisionin Institucional Zgjedhor si dhe janë të përfshirë në procesin e vetëvlerësimit.</p> <p>[Evidenca 2.2 Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL; Evidenca 2.3 Rregullore e Këshillit Studentor; Tabela 24 - Të dhëna për anëtarët e</p>

	NJBSC; evidenca 5.7 Vendimi për Komisionin Institucional Zgjedhor; evidenca 5.8 Urdhri për Komisionin e Vetëvlerësimit për Akreditimin Institucional; Evidenca 5.9 Urdhri për komisionet e përhershme Institucionale në UNIEL; Evidenca 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme në Fakultet; Evidenca 5.12 Urdhri për grupin e punës për raportin e vetëvlerësimit për programin MSHGJ; Evidenca 5.14 Vendimi i Dekanit të FSHH për ngritjen e GVB 2022].
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Konstatohet se koordinatori i programit të studimit të ciklit të dytë të studimeve MSHGJ komunikon me studentët lidhur me problematikat që ata mund të kenë për sa i përket ngarkesës mësimore si dhe përparimin e studentëve për njohjen në mënyrë të plotë apo të pjesshme të studimeve të mëparshme. Koordinatorin kujdeset për përfshirjen e studentëve në procesin e rishikimit të kurrikulës së programit dhe merr sugjerime për përmirësimin e tij, përmes mbledhjeve të përbashkëta me studentë në vijim dhe të diplomuar dhe duke propozuar hartimin e pyetësorëve për ish-studentët tashmë të punësuar. [Evidenca Evidenca 5.15 Pyetësori i Alumnit zhvilluar nga departamenti i gjuhësisë; Tabela 23 - Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve; Evidenca 3.14 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit “Master i shkencave në gjuhësi” (në 3 vite)]
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Sipas dokumentacionit pohojmë se nëpërmjet akteve normative rregullatore, UE ka garantuar barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Në rastet kur studentët janë të pakënaqur me rezultatet e vlerësimit, ai paraqet një ankesë pranë drejtuesit të njësisë bazë. Ky i fundit ngre një komision rivlerësimi (i cili nuk është i njëjtë me komisionin e parë), i cili rishqyrton dokumentacionin e provimit në mënyrë transparente. Vendimi i komisionit të rivlerësimit është i formës së prerë dhe depozitohet në departament dhe në sekretarinë mësimore. [Evidenca 1.2 Rregullore e studimeve të UNIEL; Evidenca 1.7 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Humane; Evidenca 1.8 Rregullore e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi”; Evidenca 1.14 Rregullore e departamentit të gjuhësisë]
Konkluzione	<i>Studentët janë të angazhuar në Senatin Akademik UNIEL. Studentët janë organizuar në Këshillin Studentor dhe kanë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tyre. Në përputhje me rregulloret e UE-së si dhe me rregulloren e brendshme të FSHH-së dhe departamentit të hjuhësisë, përfaqësues të studentëve janë të përfshirë në komisionet e ngritura në FSHH dhe në UE. Ata gëzojnë të drejtën e pjesëmarrjes në këto komisione, të përcjelljes së problematikave të studentëve, të diskutimit, si edhe të drejtën e votës</i>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X


Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Konstatohet se UE ka njësi të posaçme të informimit e shërbimit të studentëve. Këto struktura janë institucionale (sekretaritet, zyra e IT, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI. Institucioni vë në dispozicion të studentit rubrikën e transparencës, sipas një programi online të miratuar më parë.</p> <p>Drejtoria e Këshillimit dhe Karrierës dhe ALUMNI ka në funksionin e saj informimin e studentëve si dhe shërbime të tjera që mund të ofrohen për studentët si asistencë, këshillimi etj.</p> <p>[Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; evidenca 5.12 Miratimi dhe funksionimi i Programit të Transparencës UNIEL; Evidenca 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Vërejmë se Drejtoria e Këshillimit, Karrierës dhe ALUMNI funksionon pranë UE. Kjo drejtori në mënyrë të posaçme ka si detyrë funksionale informimin, këshillimin, dhe ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre edhe për tregun e punës.</p> <p>Gjithashtu, në UE funksionon Drejtoria e Standardeve dhe e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila ka si detyrë dhënien e ekspertizës për përmirësimin e procesit mësimor dhe për programet e studimit. Kjo drejtori ofron ekspertizë si për cilësinë e mësimdhënies, vlerësimin e përfshirjen e studentëve në procesin e të nxënës.</p> <p>Në të njëjtën linjë me këtë drejtori, funksionon edhe Komisioni i garantimit të standardeve të cilësisë pranë FSHH-së, komision në të cilin departamenti i gjuhësisë përfaqësohet me një anëtar, pedagog dhe student të këtij departamenti.</p> <p>[Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe</p>	<p>Në dosje pohohet se UE ka njësi të posaçme për këshillimin e karrierës. Drejtoria e Këshillimit dhe Karrierës dhe ALUMNI ka në funksionin e saj informimin e studentëve si dhe shërbime të tjera që mund të ofrohen për studentët si asistencë, këshillimi etj.</p>


<p>periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Departamenti i gjuhësisë mundëson, bazuar në marrëveshjet institucionale, praktikat e studentëve për programin e studimit të ciklit të dytë MSHGJ e jo vetëm për studentët e këtij programi studimi.</p> <p>[Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; Evidenca 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës]</p>		
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Vërejmë se njësia e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI asiston në gjurmimin e studentëve. Kjo njësi ka krijuar një databazë të të dhënave të gjurmimit të studentëve, e cila përditësohet me të dhëna për çdo vit. Kjo njësi ka si detyrë funksionale ndihmesën, informimin, asistimin e studentëve jo vetëm kur ata janë në vazhdim të ndjekjes së studimeve të tyre, por edhe pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Në dosje pohohet se qëllimi i ndjekjes së studentëve pas përfundimit të studimeve është që jo vetëm të krijohen statistika reale brenda UE-së, por njëkohësisht për të përmirësuar cilësinë e studentëve, duke i ndihmuar të përshtaten me tregun e punës si dhe për t'i informuar dhe orientuar për mundësitë e reja të punësimit.</p> <p>Gjithashtu gjurmimi dhe ndjekja e studentëve pas përfundimit të studimeve u vihet në dispozicion edhe departamenteve, duke i ndihmuar ata të kenë një pikë kontakti midis studentëve të diplomuar dhe FSHH-së edhe në të ardhmen.</p> <p>[Evidenca 5.6 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve 2020-2021/2021-2022; Evidenca 5.17 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës; Tabela 23 - Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UE ka njësi të posaçme të informimit e shërbimit të studentëve. Këto struktura janë institucionale (sekretaritë, zyra e IT, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI asiston në gjurmimin e studentëve. Kjo njësi ka krijuar një databazë të të dhënave të gjurmimit të studentëve, e cila përditësohet me të dhëna për çdo vit</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>
--	------------------------------	-----------------------------	---------------------------------------




VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Konstatohet se ka një udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.</p> <p>UE kualifikon stafin akademik në fushën e kërkimit, duke e konsideruar këtë si prioritet strategjik në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të mësimdhënies. Personeli akademik trajnohet vazhdimisht për përmirësimin e mësimdhënies, nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të projekteve në të cilat UE është partner.</p> <p>UNIEL ka hartuar edhe një udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies që lidhen me mësimin në distancë.</p> <p>[Evidenca 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personleve; 6.1 Guida e pedagogut: Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams]</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Sipas dokumentacionit, pohohet se pranë Rektoratit të UE-së është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorin e studentëve për matjen e performancës. Të dhënat publikohen me qëllim arritjen e një audience të gjerë mbi rezultatet dhe rekomandimet. Kjo njësi mbështetet dhe nga Komisioni i Përhershëm Sigurimit të Cilësisë në UNIEL dhe Komisioni për Sigurimin e brendshëm të cilësisë në Fakultet.</p> <p>GVJ verën se hapësirat e stafit të MGJSH në trajnime e pjesëmarrje dhe jashtë vendit, në kuadër të projekteve në të cilat UE është partner janë të pakta numerikisht.</p> <p>[Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; Evidenca 5.9 Urdhri për Komisionet e përhershme Institucionale në UNIEL; Evidenca 5.10 Urdhri për Komisionet e përhershme në Fakultet]</p>




<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Konstatohet se në Komisionin e Përhershëm për Standardet e Cilësisë, si edhe në komisione të tjera në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti, ka përfaqësues një anëtar të studentëve nga programe dhe cikle të ndryshme studimi. Të drejtat e tyre për t'u përfaqësuar në strukturat e komisioneve të ndryshme në të gjitha këto nivele, si edhe për të bërë ankimime, janë të sanksionuara me dokumente rregullatore.</p> <p>Gjithashtu, në departamentin e gjuhësisë, ka formularë të vlerësimit të performancës së pedagogut, i cili plotësohet në mënyrë anonime prej studentëve në fund të çdo kursi universitar. Rezultatet i shërbejnë përmirësimit të metodave dhe cilësisë së mësimdhënies dhe elementeve të tjera që lidhen me procesin mësimor.</p> <p>[Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; Evidenca 4.19 Vlerësimi i performancës së personelit akademik; Evidenca 5.8 Urdhri për ngritjen e Komisionit të Vetëvlerësimit për Akreditimin Institucional]</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Vërejmë se pranë rektoratit të UE-së është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorin e studentëve për matjen e performancës. Rezultatet janë bërë publike vetëm së fundmi.</p> <p>[Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022]</p> <p>Në institucion nuk organizohen trajnime për përmirësimin e aftësive profesionale të stafit akademik në fushë të hartimit të projekteve shkencore dhe nuk ka në UE njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit mund të pohojmë se sektori i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Drejtorisë së Kurrikulave vlerëson rezultatet e marra nga pyetësorët vlerësues të procesit të mësimdhënies nga studentët dhe harton raporte, të cilat iu dërgohen për shqyrtim fakulteteve dhe departamenteve etj., të cilat publikohen në faqen zyrtare të UNIEL-it.</p> <p>[Shih Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UE kualifikon stafin akademik në fushën e kërkimit, duke e konsideruar këtë si prioritet strategjik në funksion të përmirësimit të mëtejshëm të mësimdhënies. Personeli akademik trajnohet vazhdimisht për përmirësimin e mësimdhënies, nëpërmjet pjesëmarrjes në trajnime brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të projekteve në të cilat UE është partner.</i></p> <p><i>GVJ verën se hapësirat e stafit të MGJSH në trajnime e pjesëmarrje dhe jashtë vendit, në kuadër të projekteve në të cilat UE është partner janë të pakta numerikisht.</i></p>




	<i>GVJ vëren se në UE nuk ka njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Konstatohet se pranë rektoratit të UE-së është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorët institucionalë për matjen e performancës. Të dhënat publikohen me qëllim arrijten e një audience të gjerë mbi rezultatet dhe rekomandimet. Pyetësorët realizohen dy herë në vit, para fillimit të çdo sezoni të provimeve. Kjo procedurë realizohet nëpërmjet urdhrave të posaçëm. Struktura e kësaj drejtorie garanton që veprimtaria institucionale të zhvillohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, statutit dhe akteve të tjera të brendshme të UE-së.</p> <p>[Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; Evidenca 6.3 Urdhrat për zhvillimin e pyetësorëve institucionalë 2021-2022]</p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	<p>Vërejmë se UE për Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë operon vetëm me një strukturë të posaçme, e ngritur pranë rektoratit, për të bërë funksional e për të garantuar zbatimin e strategjisë zhvillimore institucionale në planin afatgjatë.</p> <p>UE "A.Xhuvani" zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p> <p>[Evidenca 1.3 Strategjia e UNIEL]</p>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që	<p>Vërejmë se institucioni i është nënshtruar dy herë procesit të akreditimit institucional. Në vlerësimin e fundit, akreditimi i tij ka qenë maksimal me 6 vite.</p> <p>UE, përmes politikave që ndjek dhe strukturave që merren me vlerësimin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, harton raporte vjetore lidhur me monitorimin dhe sigurimin e cilësisë edhe në FSHH dhe njësitë bazë të saj, ndër të cilat edhe departamenti i gjuhësisë.</p>



<p>promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>Programi i studimeve MSHGJ nuk i është nënshtruar akreditimeve të tjera të mëparshme të jashtme. Dhe ky raport i hartuar në vitin 2022 po i shërben këtij procesi.</p> <p>[Evidenca 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional; Evidenca 6.6 Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm për Akreditimin Institucional (UE); https://ëëë.uniel.edu.al/universiteti-ue/analiza-dhe-raporte/891-raporti-i-vetevleresimit-te-brendshem-per-akreditimin-institucional https://ëëë.uniel.edu.al/images/njoftime/Raporti_i_vetevleresimit_per_akreditimin_institucional.pdf]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Mund të pohojmë se UE në zbatim të akteve rregullatore përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit MSHGJ, i cili kontrollohet nga Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm për Standardet dhe Cilësinë në nivel universiteti dhe fakulteti.</p> <p>Këto struktura, Fakulteti i Shkencave Humane dhe departamenti i gjuhësisë, si njësi përgjegjëse për mbarëvajtjen e programeve të mësimin të këtij departamenti, ndjekin me përgjegjësi problemet që lidhen me mësimin e me zbatimin e programit të studimit MSHGJ. Lidhur me këtë kontrollohet ecuria e procesit mësimor dhe përputhjen e tij me planin e programit MSHGJ, zbatimin e tij, korrektësinë e zhvillimit të procesit mësimor, kërkimin gjuhësor në terren, provimet, mbajtjen e dokumentacionit përkatës.</p> <p>FSHH dhe departamenti i gjuhësisë kanë përdorur disa metoda për realizimin e vlerësimit, si: pyetësorë me studentët, inspektime gjatë zhvillimit të mësimin nga përfaqësuesit e dekanatit të FSHH-së, leksione të hapura e dëgjime në auditor, intervista, vlerësim të detyrave dhe të provimeve të studentëve, vëzhgime gjatë kryerjes së kërkimit gjuhësor në terren etj.</p> <p>[Evidenca 4.19 Vlerësimi i performancës së personelit akademik; Evidenca 6.6 Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm për Akreditimin Institucional (UE); Evidenca 3.14 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit “Master i shkencave në gjuhësi” (në 3 vite)]</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UE në zbatim të akteve rregullatore përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit MSHGJ, i cili kontrollohet nga Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisioni i Përhershëm për Standardet dhe Cilësinë në nivel universiteti dhe fakulteti. Pranë rektoratit të UE-së është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorët institucionalë për matjen e performancës.</i></p>



Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet		
	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
			X

Standardi VI.3


Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njërive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Konstatohet se programi i studimeve MSHGJ nuk i është nënshtruar akreditimeve të tjera të mëparshme të jashtme.</p> <p>Nga ana tjetër, departamenti i gjuhësisë ka përdorur disa metoda për realizimin e vlerësimit të brendshëm, si: pyetësorë me studentët, pyetësorë për stafin akademik, leksione të hapura e dëgjime në auditor, intervista, vlerësim të detyrave dhe të provimeve të studentëve, vëzhgime gjatë kryerjes së kërkimit gjuhësor në terren, pyetësor për alumnin etj.</p> <p>Mbi bazën e kësaj analize mundësohet vlerësimi i performancës dhe ngarkesës së stafit akademik për programin e studimit MSHGJ. Krahasimisht hartohen raporte mbi rezultatet e këtyre vlerësimeve, të cilat dokumentohen dhe u dërgohen autoriteteve në nivel fakulteti dhe Senati.</p> <p>[Evidenca 1.29 Raport për veprimtarinë e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi” për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 1.32 Analiza vjetore e departamentit të gjuhësisë 2020-2021; Evidenca 4.19 Vlerësimi i performancës së personelit akademik; Evidenca 6.6 Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm për Akreditimin Institucional (UE)]</p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Konstatohet se në përmblyllje të vitit akademik personeli akademik i departamentit të gjuhësisë diskuton dhe përcjell te dekanati i FSHH-së analizën vjetore. Mbi këto analiza, dekanati përgatit analizën vjetore të fakultetit, duke ia dërguar Senatit të UE-së. Përmbledhja e këtyre problematikave në analizën vjetore të FSHH-së dhe komunikimi i këtij informacioni në Senatin e UE-së krijon një mundësi të mirë për të krijuar të gjitha kushtet për ndryshimet e nevojshme dhe garantimin e rritjes së cilësisë së programit të studimit dhe përshtatjen me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>[Evidenca 1.29 Raport për veprimtarinë e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi” për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 1.32 Analiza vjetore e departamentit të gjuhësisë 2020-2021; Evidenca 1.11 Analiza vjetore institucionale 2020-2021]</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Vërejmë se UE nëpërmjet strukturave të ngritura, si sektori i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, pranë Drejtorisë së Standardeve, ajo e Këshillimit të Karrierës dhe strukturave të tjera të posaçme në fakultete e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



<p>përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>departamente organizojnë punën, ndjekin dhe kontrollojnë procesin mësimor dhe përputhshmërinë e tij me planin mësimor të MSHGJ-së dhe programet për zbatimin e tij. Metodologjia e vlerësimit bashkë me instrumentet e përdorura nga palët e përfshira në këtë proces vlerësimi janë përcaktuar dokumentet që lidhen me standardet e cilësisë së arsimit të lartë.</p> <p>Ndërkohë nuk përdoren metodat specifike të vlerësimit të drejtpërdrejtë cilësisë së programit të studimit sa kohë që nuk ka institucione të sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel departamenti dhe fakulteti.</p> <p>[Evidenca 1.29 Raport për veprimtarinë e programit të studimit “Master i shkencave në gjuhësi” për vitin akademik 2020-2021; Evidenca 3.14 Procedura e ndjekur për përmirësimin e kurrikulës së programit “Master i shkencave në gjuhësi” (në 3 vite)]</p>		
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Konstatohet se pranë rektoratit të UE-së është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorët institucionalë për matjen e performancës. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI mbledh dhe përpunon periodikisht të dhëna në lidhje me gjurmimin dhe punësimin e studentëve.</p> <p>Departamenti i gjuhësisë harton pyetësorin me alumnin, në lidhje me punësimin dhe ka në plan ta hartojë edhe për përmirësimin e kurrikulës, në kuadër të përditësimit të njohurive dhe lidhjes më të ngushtë të universitetit me shkollën dhe shkencën e gjuhësisë.</p> <p>[Shih Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; Evidenca 5.15 Pyetësori i alumnit zhvilluar nga departamenti i gjuhësisë; Tabela 23 - Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve]</p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Departamenti i gjuhësisë ka përdorur disa metoda për realizimin e vlerësimit të brendshëm, si: pyetësorë me studentët, pyetësorë për stafin akademik, leksione të hapura e dëgjime në auditor, intervista, vlerësim të detyrave dhe të provimeve të studentëve, vëzhgime gjatë kryerjes së kërkimit gjuhësor në terren, pyetësor për alumnin etj.</i></p> <p><i>Mbi bazën e tyre mundësohet vlerësimi i performancës dhe ngarkesës së stafit akademik për programin e studimit MSHGJ. Pranë rektoratit të UE-së është ngritur dhe funksionon Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të cilësisë, i cili në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorët institucionalë për matjen e performancës.</i></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>

Standardi VI.4


Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Vërejmë se në përputhje me strukturën organizative dhe hierarkinë e UE-së përgjegjësitë për cilësinë janë të shtrira në të gjitha nivelet drejtuese (departament, fakultet, rektorat). Strukturat në fjalë planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave dhe procedurave për realizimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Standardet për sigurimin e cilësisë së institucionit hartohen në përputhje me Manualin e Sigurimit të Brendshëm dhe Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë.</p> <p>Departamenti mban kontakt përmes faqeve në mediat sociale (Facebook dhe instagram) me të diplomuarit e vet, të cilët vlerësojnë në mënyrë spontane dhe sporadike veprimtari shkencore, por edhe mësimore të departamentit.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Sipas dokumentacionit, pohojmë se UE ka të përcaktuar në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të saj detyrat konkrete për komisionet e përhershme të garantimit të standardeve të cilësisë.</p> <p>Komisioni i Garantimit të Standardeve të Cilësisë dhe të Programeve të Studimit, një komision i përhershëm institucional i ngritur pranë FSHH-së përbëhet nga katër anëtarë të personelit akademik dhe një përfaqësues të studentëve.</p> <p>Sigurimi i brendshëm i cilësisë së programit të studimit MSHGJ, është konceptuar si përgjegjësi dhe angazhim lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Harmonizimin e veprimtarisë së të gjithë strukturave drejtuese për të garantuar cilësinë e programit të studimit MSHGJ; - Sigurimin e burimeve njerëzore dhe infrastrukturës për të garantuar dhe përmirësuar cilësinë e programit të studimit MSHGJ; - Hartimin e një programi cilësor që plotëson nevojat e shoqërisë; - Përcaktimin e parimeve, standardeve dhe procedurave të përshtatshme për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë. <p>[Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe Funksionimit UNIEL; Evidenca 6.7 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë]</p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.</p>	<p>Konstatojmë se programi i studimeve MSHGJ nuk u është nënshtruar akreditimeve të tjera të mëparshme të jashtme. Dhe ky raport i hartuar në vitin 2022 po i shërben këtij procesi.</p> <p>Në hartimin e këtij raporti është përfshirë departamenti që e ofron këtë program studimi dhe është përgjegjës për këtë program, departamenti i gjuhësisë, i anëtarëve të personelit akademik të këtij departamenti, dhe ka të përfshirë edhe studentët të këtij programi.</p>

	[Evidenca 6.7 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë; Evidenca 5.14 Vendimi i Dekanit të FSHH për ngritjen e GVB 2022]			
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Sipas dokumentacionit mund të pohojmë se në hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm të MSHGJ është përfshirë departamenti që e ofron këtë program studimi dhe është përgjegjës për këtë program - departamenti i gjuhësisë - i anëtarëve të personelit akademik të këtij departamenti, dhe ka të përfshirë edhe studentë të këtij programi. Aktorët e përfshirë në këtë proces janë persona që gëzojnë një reputacion të pranueshëm akademik dhe procedura e vlerësimit të brendshëm i nënshtrohet Kodit të Etikës të Miratuar në UNIEL. [Evidenca 6.5 Kodi i Etikës UNIEL; Evidenca 6.7 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë]			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në dosje pohohet se në procesin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit dhe të akreditimit institucional në UE nuk janë përfshirë ende ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit dhe që mund të japin ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.			
Konkluzione	<i>Përgjegjësitë për cilësinë janë të shtrira në të gjitha nivelet drejtuese (departament, fakultet, rektorat). Në procesin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit dhe të akreditimit institucional në UE nuk janë përfshirë ende ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit dhe që mund të japin ekspertizë e mendime në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
		X		


Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të	Në dokumentacion pohohet se në UE instrumenti më i përdorur lidhur me vlerësimin e cilësisë së programit të studimit MSHGJ është pyetësori institucional me studentët. Ky i fundit organizohet në përfundim të çdo

<p>Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>semestri apo në fillim të sezonit të provimeve, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët. Rezultatet e pyetësorëve përpunohen dhe i vihen në dispozicion drejtuesve të institucionit, si edhe palëve të interesuara dhe gjithashtu, publikohen në faqen zyrtare të UNIEL-it. Studentët mund të njihen, kështu, me rezultatet e këtij pyetësori.</p> <p>[Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; Evidenca 6.6 Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm për Akreditimin Institucional (UE)]</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Vërejmë se UE publikon të dhënat e realizuara si rezultat i pyetësorëve institucionalë me qëllim arritjen e një audience të gjerë mbi rezultatet dhe rekomandimet. Gjatë hartimit të raportit respektohet liria dhe etika akademike, në përputhje me parashikimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi.</p> <p>Gjithashtu, UE e ka publikuar raportin e vetëvlerësimit të brendshëm për akreditimin institucional në faqen e vet ueb për të gjithë aktorët që kanë lidhje me universitetin dhe publikun e interesuar.</p> <p>[Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; Evidenca 6.5 Kodi i Etikës UNIEL; Evidenca 6.6 Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm për Akreditimin Institucional (UE)]</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Konstatojmë se rezultatet e vlerësimit të brendshëm, të procesit të akreditimit dhe rekomandimeve të vlerësuesve të jashtëm raportohen pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Këto njësi, rekomandojnë detyra, zbatim i të cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese. Gjetjet dhe rekomandimet në çdo rast janë shoqëruar edhe me marrjen e masave konkrete.</p> <p>[Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; Evidenca 6.6 Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm për Akreditimin Institucional (UE)]</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në dosje pohohet se UE vlerëson dhe siguron që veprimtaritë akademike, mësimore dhe shkencore të kenë ndikim dhe lidhje me procesin e mësimdhënies akademike dhe të nxisin përmirësimin në vijim të cilësisë së programeve të studimit që ofron. Veprimtaritë e zhvilluara nga departamenti i gjuhësisë lidhen me përmbajtjen e programit MSHGJ dhe kjo garanton përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies e kërkimit shkencor në kuadër të këtij programi studimi.</p> <p>[Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; Evidenca 6.6 Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm për Akreditimin Institucional (UE)]</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin</p>	<p>Në mbështetje të dokumentacionit, mund të pohojmë se UE investon në vijimësi për trajnimin e pedagogëve, me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë. Këto trajnime lidhen kryesisht me metodikën e mësimdhënies, si dhe njohjen e rregulloreve të brendshme të institucionit në të gjitha nivelet. Pedagogët e departamentit të gjuhësisë kanë dhënë mësim dhe</p>



afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	<p>janë trajnuar jo vetëm në UE, por edhe në universitete jashtë vendit, me të cilat UE-ja ka marrëveshje bashkëpunimi, si: mobilitetet që ofrojnë programet ERASMUS+ etj.</p> <p>Pjesëmarrja e studentëve të programit të studimit MSHGJ-së në trajnime, veprimtari kërkimore e shkencore, konferenca studentore, takimet me përfaqësues të ASCAL-it, botime në Buletinin special për studentët të drejtuar nga pedagogët etj., mundëson informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit të FSHH-së, e në veçanti të departamentit të gjuhësisë.</p> <p>[Evidenca 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; Evidenca 6.6 Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm për Akreditimin Institucional (UE); Evidenca 3.2 Të dhëna për mobilitetin e personelit akademik]</p>			
Konkluzione	<p><i>Në UE instrumenti më i përdorur lidhur me vlerësimin e cilësisë së programit të studimit MSHGJ është pyetësori institucional me studentët. Ky i fundit organizohet në përfundim të çdo semestri apo në fillim të sezonit të provimeve, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët. Studentët mund të njihen, kështu, me rezultatet e këtij pyetësori.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht	
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht	
			X	



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i shkencave në Gjuhësi ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Aleksandër Xhuvani”, Elbasan.

Pikat e forta dhe afirmime


1. Studimet gjuhësore në këtë universitet janë themeltare, programi është në vazhdimësi të një tradite shumëvjacare në këtë universitet dhe pjesa më e madhe e stafit akademik janë formuar prej profesoratis themelues të këtij programi dhe që kanë qenë gjuhëtarë të afirmuar. Në fillimet e veta ky program studimi i ciklit të dytë nisi edhe me mësimdhënien akademike të këtyre gjuhëtarëve të afirmuar. Stafi aktual është i vendosur ta çojë përpara këtë traditë: mësimdhënie dhe kërkim shkencor aktiv dhe duke përfshirë studentët.
2. Programi ka kurrikul cilësore krahasimisht me programe studimi në fakultete të tjera simotra.
3. MSHGJ është pjesë e ciklit të plotë të studimeve universitare: departamenti i gjuhësisë ka programin “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”, në ciklin e parë; “Master i shkencave në gjuhësi”, në ciklin e dytë, dhe “Doktoratë në albanologji”, profili gjuhësi, në ciklin e tretë të studimeve.

Pika të dobëta

1. Në institucion nuk organizohen trajnime për përmirësimin e aftësive profesionale të stafit akademik në fushë të hartimit të projekteve shkencore dhe nuk ka në UE njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. **Standardi VI.1, kriteri IV.**
2. Në procesin e vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit dhe të akreditimit institucional në UE (por edhe për këtë program studimi) nuk janë përfshirë ende ekspertë të jashtëm që kanë lidhje profesionale dhe të interesit shkencor me programin e studimit. **Standardi VI.4, kriteri V.**
3. Studentët e MSHGJ nuk janë përfshirë në mobilitete për të përfituar nga financime të Universitetit dhe përtej (institucioneve evropiane). **Standardi II.7, kriteri 2.**

Rekomandime

1. Të ngrihet në nivel fakulteti e departamenti grupi i përhershëm i vlerësimit të brendshëm, që monitoron dhe vlerëson në mënyrë të vijueshme programin e studimit dhe harton raporte për cilësinë e tij.
2. Të kryhet vlerësimi i tërthortë përmes pyetësorëve të studentëve për vlerësimin e performancës dhe programit të studimit.
3. Të krijohet një lidhje më e ngushtë me alumnin, në nivel fakulteti e departamenti për t'i përfshirë edhe më shumë studentët në procedurat e përmirësimit të kurrikulës (planit mësimor) dhe afrimit të saj me nevojat e profesionistit në tregun e punës.
4. Të shihet me përparësi shkëmbimi i stafit e studentëve në mobilitetet dhe përfshirje në programet Easmus.



Conclusions of the Evaluation of the second cycle Master of Science in Linguistics study program offered by the Higher Education Institution "Aleksandër Xhuvani University", Elbasan.

Strengths and Affirmations


1. Linguistic studies at this university are fundamental, the program is a continuation of a long-standing tradition at this university and most of the academic staff were formed by the founding professors of this program and who were established linguists. In its beginnings, this second cycle study program also started with the academic teaching of these affirmed linguists. The current staff is determined to carry forward this tradition: teaching and active research by involving students.
2. The program has a quality curriculum compared to study programs in other sister faculties.
3. The Ministry of Education is part of the full cycle of university studies: the linguistics department has the program "Bachelor In Albanian Language And Literature", in the first cycle; "Master of Science in Linguistics", in the second cycle, and "Doctorate in Albanianology", linguistic profile, in the third cycle of studies.

Weak points


1. The institution does not organize trainings to improve the professional skills of the academic staff in the field of scientific project design, and there are no units in the EU at the institutional level that promote the continuous improvement of teaching. **Standard VI.1, criterion IV.**
2. In the process of internal evaluation of study programs and institutional accreditation in the EU (but also for this study program), external experts who have professional connections and scientific interests with the study program have not yet been included. **Standard VI.4, criterion V.**
3. MSL students are not involved in mobilities to benefit from funding from the University and beyond (European institutions). **Standard II.7, criterion 2.**

Recommendations

1. To establish a permanent internal evaluation group at the faculty and department level, which continuously monitors and evaluates the study program and prepares reports on its quality.
2. To carry out indirect assessment through student questionnaires for the assessment of performance and the study program.



3. To create a closer connection with the alumni, at the faculty and department level, to further involve the students in the procedures of improving the curriculum (learning plan) and bringing it closer to the needs of professionals in the labor market.
4. Priority should be given to the exchange of student staff in mobilities and involvement in Erasmus programs.

Handwritten signature and initials in blue ink. The signature is a cursive name, and the initials are a stylized 'X'.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

